# GAZETA SHQIPTARE




Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIII - Nr. 7313 E enjte 5 Tetor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)




Opinioni i Ditës

Nga ILIR KALEMAJ

## Sfidat e NATO-s

NATO sot ballafaqohet me kriza që shkojnë nga sulmet kibernetike, te rrezikshmëria e çmendurisë së Kim Yong Un-it, që ndryshe nga sivëllezërit ...

Vijon në faqen 20





Dje në "Deutsche Welle"

Nga RUPERT WIEDERWALD

## Toni i duhur në kohën e duhur

Në vend që të mbajë fjalimin numër X për ribashkimin e Gjermanisë, Presidenti Steinmeier u kujton gjermanëve detyrimet për rezultatin e zgjedhjeve ...

Vijon në faqen 21

SI PERLLOGARITET MASA E PARAVE QE DO MERRET PAS DALJES NGA PUNA

# PENSIONET FAMILJARE, JA CILET PERFITOJNE

Kriteret dhe dokumentet që ju nevojiten. Si shpërblehen jetimët për dy prindërit e vdekur dhe kategoritë e ngjashme. Hapat që duhet të ndiqni për të marrë pagesën



(Në foto) Pensionistë (foto Ilustruese)

Në faqen 9



Lista e parë me emrat e miratuar

## Ish të-përndjekurit, 2 mijë trashëgimtarë që përfitojnë dëmshpërblimin

Ministria e Financave: Afatet për plotësimin e dosjes nga nipërit e ish-të dënuarve

Nga ORNELA MANJANI

Ministria e Financave ka publikuar listën e kategorisë joparësore në radhët e ish-të përndjekurve politikë që mund të trajtohen me dëmshpërblim, por që sipas këtij dikasteri duhet të sjellin ...

Në faqet 14-17

RINGRITJA E PARTISE

## Lëvizjet në PD, Bode e Patozi: Nuk synojmë fraksione brenda partisë

Në faqen 2

DEPUTETI I PDIU

## PD: Të hetohet Aqif Rakipi. Llalla takon Ramën: Po bëjmë verifikime

Në faqen 5

BILBIL RAKIPI

## Flet babai i viktimave të 'Çoles': Me Llanajt s'kemi hakmarrje

Në faqen 10

EKSPERTI I ARSIMIT

## Akreditimi i universiteteve, Zhapaj: Qeveria do ta zhvlerësojë UT

Në faqen8

PRONAT NË VERI



## Pronarët në Shkodër, kush është kompensuar e statusi i pronës

Në faqet 18-19

Gjyqi për grupin e hashashit, flet Ilirjan Malo, babai i njërit prej djemve

# Banda e Lazaratit, flet i ati i Malos

*"Si u ndodh im bir në Lazarat, njihte vetëm Albanon"*

Nga INA ALLKANJARI

Djali im është i pafajshëm. Ai nuk është i përfshirë në sulmin me armë ku u vra Ibrahim Basha. Ne jemi nga Gjirokastra dhe nuk e di se si ai u gjend në Lazarat. Unë e dija që Xhuljano ndodhej në lagje". Kështu deklaroi dje në një intervistë ekskluzive për "Gazeta Shqiptare" Ilirjan Malo, babai i të pandehurit Xhuliano Malo. Ky i fundit dyshohet të jetë njëri prej të pandehurve që mori pjesë në sulmin me armë ndaj policisë në Lazarat në qershor të 2015-ës, ...



Në faqen 7

# LEVIZJA
## REAGIMET

Ringritja e PD, platforma e shpallur dorëzohet mbi tryezën e Bashës

# Bode dhe Patozi: Rizgjedhja e kryetarit, kusht i panegociueshëm

## *"Nuk synojmë fraksione, as parti të re"*

Valentina Madani

Platforma e shpallur nga lëvizja që synon ringritjen e Partisë Demokratike nga dje ndodhet zyrtarisht në zyrën e kreut të PD-së, Lulzim Basha. Bode dhe Patozi, pjesë e grupit të kritikëve të Bashës zhvilluan dje një takim informues me gazetarët. Patozi tha se platforma e paraqitur dje rrëzon idenë e fraksioneve në Partinë Demokratike. Të njëjtën gjë konfirmoi edhe Bode, duke shtuar se qëllimi i kësaj lëvizjeje brenda PD është bashkimi përmes një analize të thellë dhe jo të diktuar e më pas të shkohet në zgjedhje në të gjitha nivelet. Bode u kujdes të nënvizonte se rizgjedhja e kryetarit të PD-së është kusht i panegociueshëm. "Qëllimi i kësaj lëvizjeje nuk është të gjejë konsensus midis nesh, drejtuesve aktualë të PD, kryetarit të PD. Ka një qëllim më të gjerë se kaq, të bashkojmë të gjithë PD-në përmes një procesi analize të thellë, jo të orientuar dhe diktuar, por ashtu siç e mendojnë demokratët. Përmes kësaj analize të ftohen për të rindërtuar të gjitha organet drejtuese nga seksioni tek nivelet më të larta", deklaroi z.Bode. Ai kërkon anulimin e 22 korrikut, ku Basha mori mandatin e dytë si kryetar i PD. Rizgjedhjen e kryetarit, ai e cilëson kusht të pangeciueshëm. Ndryshe nga sa u tha ditë më parë, Bode sqaroi se lëvizja për ringritjen e PD nuk kërkon legalizim të fraksioneve. "Nuk kërkojmë as fraksion dhe as përfaqësime të cilësuara. Kërkojmë që të jemi të barabartë si çdo anëtar i PD, me të drejtën për të votuar dhe për t'u votuar", u shpreh ish-sekretari i përgjithshëm i PD-së. Në rast të mospranimit të platformës nga kryetari Lulzim Basha, anëtarët e lëvizjes për ringritjen e Partisë Demokratike do t'i drejtohen anëtarësisë për të imponuar zgjedhje të lira brenda kësaj force politike.

**KËRKESA**
Rizgjedhjen e kryetarit, Bode e cilëson kusht të pangeciueshëm. Ndryshe nga sa u tha ditë më parë, ai sqaroi se lëvizja për ringritjen e PD nuk kërkon legalizim të fraksioneve. Anëtarët e lëvizjes për ringritjen e PD-së parashikojnë edhe takime me anëtarësinë, për të imponuar zgjedhje të lira brenda kësaj force politike.


Kryeministri Edi Rama dhe ambasadori amerikan në Shqipëri, Donald Lu


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

**NJOFTIM PER SHPREHJEN E INTERESIT PËR POZICIONET E KESHILLTAREVE LIGJORE DHE EKONOMIKE PRANE KOMISIONIT PAVARUR TE KUALIFIKIMIT (KPK)**

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "*Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*", dhe vendimit te Kuvendit nr.93/ 2017, shpall vendet vakante për pozicionet **e *keshilltareve ligjore dhe ekonomike*** per institucionin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, konkretisht për **keshilltare ligjore (12) dhe keshilltare ekonomike (4).**

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 23-27.10.2017 në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së aplikantëve, se bashku me dokumentet perkatese, pranë institucionit të KPK-se në adresën**: Rruga e Kavajes, Ish-Lidhja e Shkrimtareve, Tiranë, zyra e protokollit, nga e Hëna-Premte, ora: 09:00-16:00.**

- Kërkesës me shkrim dërguar me postë zyrtare në adresën: **Rruga e Kavajes, Ish-Lidhja e Shkrimtareve, Tiranë**. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda dates 27/10/ 2017, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatin e lëshuar nga institucioni përkatës postar. KPK konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

- Kërkesë për aplikim përmes postës elektronike në adresën: komisionipavarurikualifikimit@gmail.com; tek institucioni i KPK-se, i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

**a)** **jetëshkrim profesional**, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
**b)** **kopje të dokumenteve të noterizuara ose të njësuara nga organi përkatës, që vërtetojnë kushtet e parashikuara në nenin 22, pika 3 (per keshilltare ligjore) dhe pika 4 (per keshilltare ekonomik)** te ligjit 84/2016 "*Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*.



REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI.
ADMINISTRATA**: Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416**, *Marketingu*:** Cel:0682074415***-email:marketing@gazetashqiptare.com*, ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 ***Marketingu*:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: http://www.gsh.al, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**



Kryeministri i përgjigjet ambasadorit të SHBA: "Elbasani", në ndjekje

# Lufta me bandat, Rama: Brenda pranverës, rezultate pozitive

## Konsultimi, "edhe biznesi i vogël do të përfshihet në TVSH"

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama premtoi dje, se brenda pranverës do të ketë një situatë krejtësisht të re kundër kriminalitetit në vend. Duke folur për deklaratat e ambasadorit amerikan Donald Lu, Rama u shpreh dje, gjatë një takimi konsultues për buxhetin, me qytetarë të Fierit: "Shumë mirë që e tha edhe ambasadori amerikan. Ndërkohë që ne po punojmë intensivisht në të gjithë spektrin. Ndodhi në Elbasan një ngjarje që mori një jehonë shumë të madhe mediatike, e cila shërbeu edhe si një lloj katalizatori për të rritur atë intensitetin e propagandës mbi këtë çështje, e unë ju siguroj që çështja e Elbasanit është në ndjekje të vazhdueshme. Shumë shpejt do të ketë rezultate konkrete në atë çështje, sikundër do të shihni një seri veprimesh të pandërprera të Policisë së Shtetit, për të goditur elementët kriminalë dhe të inkriminuar brenda Policisë së Shtetit". "Brenda pranverës së ardhshme do të kemi një situatë të re, krejtësisht në përpjekjen kundër këtyre lloj elementësh shqetësues për komunitetin dhe shqetësues për punën e komuniteteve dhe të vendit", - u shpreh Rama. "Më rezulton se mosha e tyre është e pjekur dhe karriera e tyre është e konsoliduar, dhe janë figura me lidhje të njohura me opozitarët e sotëm, nëse duam të bëjmë politikë, por ky nuk është qëllimi ynë", - u shpreh kryeministri. "Jam shumë i qetë, nuk më impresionojnë tundjet e flamurit amerikan sipas erës që fryn në favor apo jo. Kemi hyrë në një proces qeverisjeje ndryshe edhe në luftën kundër krimit apo për të ashtuquajtur familje apo ku di se çfarë", - deklaroi Rama.

**BUXHETI**

Këto deklarata kryeministri i bëri ndërsa nisi konsultimet publike për buxhetin e vitit 2018. Nga qarku i Fierit, ku ka prezantuar pikat kryesore të projektbuxhetit, kreu i qeverisë tha se përmes këtyre konsultimeve synohet që zërat e shpenzimeve të shkojnë aty ku është më e nevojshme. Rama tha se procesi i vetingut dhe reforma në drejtësi i japin fund korrupsionit në nivele të larta. "Jemi në udhëkryq sa i



Kryeministri Edi Rama

takon luftës kundër korrupsionit në të gjitha nivelet, për ne është parësore, në këtë moment si qeveri, reforma në drejtësi dhe procesi i vetingut, dhe kjo do të çojë përpara përpjekjen kundër korrupsionit në nivele të larta". Kreu i qeverisë kërkoi bashkëpunim me biznesin për të luftuar informalitetin. "Do t'i kërkojmë biznesit të vogël të bëhet pjesë e luftës kundër informalitetit. Të gjitha subjektet, edhe subjektet e biznesit të vogël, do të përfshihen në TVSH. Nuk është e vërtetë që do të ketë rritje taksash për biznesin e vogël. Ne e kemi bërë zero dhe do të vazhdojë të mbetet zero. Ne do ta përfshijmë në regjimin e TVSH, por kjo nuk do të thotë se do të ketë këtë rritje taksash. Çdo biznes i vogël do të sillet në mënyrë të strukturuar", - tha Rama. Gjatë bashkëbisedimit me kryeministrin Rama, ka ndërhyrë edhe kreu i Bashkisë së Mallakastrës, Agron Kapllanaj, i cili i ka kërkuar kreut të qeverisë që të mos bëjë diferencime në dhënien e buxhetit, siç është bërë deri më tani, sipas tij.

**TAKIMI**

Kryeministri Edi Rama u takua dje paradite në kryesinë e Kuvendit me kryetarin e Kuvendit, Gramoz Ruçi si dhe me ministrin e Brendshëm, Fatmir Xhafaj. Mendohet se në qendër të bisedës kanë qenë edhe deklaratat e forta të ambasadorit amerikan Donald Lu, për lidhjet e krimit në Shqipëri.

**KE**

Takimi i tetë i Komitetit të Stabilizim-Asocimit mes Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian u mbajt në Bruksel. Pas këtij takimi, Komisioni Evropian ka mirëpritur progresin në këto fusha dhe ka nënvizuar nevojën për të parë rezultate, veçanërisht në reformën e drejtësisë dhe procesin e vetingut. Por ka lënë detyrë që të trajtohet çështja e azilkërkuesve.



Donald Lu

"Kam në plan të largohem në verën e 2018"

## Ambasadori i SHBA, Donald Lu: Dua të zgjas mandatin tim në Shqipëri

Ambasadori Amerikan në Shqipëri, Donald Lu, i cili është vënë në qendër të vëmendjes mediatike së fundmi për deklaratat e tij për 4 klanet dhe 20 familjet kriminale, ka bërë sot një tjetër deklaratë, ndryshe nga e para. Në një prononcim për "News24", ai e ka quajtur Shqipërinë një vend të bukur dhe se do të donte të zgjaste mandatin e tij si kryediplomat në këtë vend. Nuk dimë nëse kjo do të jetë e mundur, por Lu tha se do ta kërkonte një gjë të tillë. I pyetur nëse do të largohet në muajin janar 2018, kur i përfundon edhe afati si ambasador, ai u përgjigj: "Ka qenë një nder i madh për mua dhe familjen time që kemi qenë këtu në Shqipëri në këto dy vite e gjysmë. E kemi shijuar aq shumë mikpritjen shqiptare, sa kam kërkuar të qëndroj edhe më gjatë në këtë vend të bukur. Kam në plan të largohem nga Shqipëria në verën e vitit 2018. Deri atëherë, kemi shumë më tepër për të bërë së bashku".

> "Ka qenë një nder i madh për mua dhe familjen time që kemi qenë këtu në Shqipëri në këto dy vite e gjysmë".

LSI mbledh komitetin drejtues: Nuk jemi në opozitë me PS

## Kryemadhi: Front i përbashkët opozitar kundër keqqeverisjes



Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi u bëri thirrje dje, të gjithë faktorëve të majtë e të djathtë që të bashkohen në një front të gjerë opozitar kundër keqqeverisjes. Në fjalën e saj në Komitetin Drejtues Kombëtar të LSI-së, Kryemadhi tha "se rreziku më i madh që ka Shqipëria është krimi i organizuar, i cili është i kapur që nga kreu i qeverisë dhe duke vazhduar në çdo segment qeverisës". "Koha nuk pret më tashmë për të krijuar një front të përbashkët opozitar me të gjithë faktorët politikë të majtë, të djathtë, shoqëri civile, botë akademike, qytetarë kundrejt kësaj keqqeverisje arrogante që kërcënon të tashmen dhe të ardhmen e qytetarëve shqiptarë. Ne jemi të hapur dhe nuk kemi asnjë kompleks sa i përket bashkëqeverisjes së frontit opozitar, ku për mua do të ishte e drejtë të quhej: Fronti Kombëtar kundër Krimit të Organizuar, sepse rreziku më i madh që ka Shqipëria është krimi i organizuar, i cili është i kapur që nga kreu i qeverisë dhe duke vazhduar në çdo segment qeverisës", - tha Kryemadhi. "Ne si LSI nuk jemi në opozitë me Rilindjen, as me PS-në; ne jemi në opozitë me keqqeverisjen dhe në opozitë me krimin e organizuar. Me këtë strukturë kriminale. e cila çdo ditë e më shumë po kap strukturat e shtetit, po kap Policinë e Shtetit dhe tashmë ka shtrirë duart drejt strukturës së drejtësisë", - u shpreh kryetarja e LSI-së. LSI-ja, sipas saj, "do të përqafojë një manifest të ri politik, ku si shtyllë kurrizore të saj do të jenë jo vetëm çështje të sigurisë dhe rendit publik, por për të mos pasur më kriminelë policë apo policë kriminelë që luajnë me jetën e fëmijëve tanë". Ajo shtoi se "ka pasur njerëz që zullumet e pista ua hodhën shpatullave të brishta të LSI-së. Kjo na ka pozicionuar në opozitë".

# DEKRIMINALIZIMI

## KERKESA

Verifikimi i të dhënave në formularët e deputetëve, PD kërkesë Prokurorisë dhe KQZ-së

# Dekriminalizimi, PD: Të hetohen Aqif Rakipi dhe Gjetan Gjetani

## "Deputetët kanë rekorde kriminale në Itali"



Gjatë një seance parlamentare

Valentina Madani

Partia Demokratike kërkoi dje, verifikimin e formularit sipas ligjit të dekriminalizimit të deputetit të PDIU-së, Aqif Rakipi dhe të PS-së, Gjetan Gjetani. Sipas shkresës së dërguar prokurorisë, PD-ja pretendon se të dy deputetët kanë rekorde kriminale. Për demokratët, Aqif Rakipi është në kushtet e ndalimit për t'u kandiduar apo për t'u zgjedhur në një funksion të lartë publik, pasi ka dyshime të arsyeshme për rekorde kriminale nga ana e tij në shtetin italian. Kërkesë të njëjtë për verifikim të dhënash, për shkak të rekordeve të dyshuara kriminale në Itali, PD-ja ka paraqitur në organin qendror të akuzës dhe në KQZ edhe për deputetin e PS-së, Gjetan Gjetani. Në shkresën që i është dërguar organit të akuzës, demokratët pretendojnë se ka dyshime për fshehjen e të dhënave për aktivitet kriminal ndaj dy deputetëve, që sipas ligjit për dekriminalizimin duhej t'i pengonte për të marrë poste publike apo për t'u zgjedhur. Në shkresë demokratët theksojnë se ka të dhëna informale se këta deputetë janë në kushtet e ndalimit për të kandiduar apo zgjedhur pasi kanë rekorde kriminale në Itali. "Kërkojmë nga ana juaj që, në zbatim të detyrimit të parashikuar nga neni 8 i këtij ligji, të bëni verifikimin e plotë të të dhënave. Kjo kërkesë e jona, bëhet në kushtet kur, pavarësisht fakteve të njohura botërisht, institucioni juaj nuk ka kërkuar verifikimin e plotë të të dhënave kryesisht", thuhet në shkresën e PD-së. Mësohet se informacionin në lidhje me dy deputetët Gjetan Gjetani (PS) dhe Aqif Rakipi (PDIU), PD-ja e ka nga partnerët ndërkombëtarë në Itali. Më 29 shkurt 2016, Partia Demokratike ka denoncuar në orët e vona deputetin Rakipi, pjesë e mazhorancës, dhe vëllanë e tij, sepse sipas saj kishin rrahur barbarisht kryetarin e PD-së së Peqinit për motive të pastra politike. Vetëm pak kohë më parë ai u përfshi në një ngjarje të rëndë, teksa aksidentoi me vdekje një person në autostradë në afërsi të Vorës, por më pas u lirua nga akuza. PD-ja në kohën e aksidentit reagoi me forcë, ndërkohë që nuk munguan akuzat e forta edhe për lidhjet e tij të afërta me kryeministrin Rama. Rakipi ishte ndër deputetët që votuan pro qeverisë "Rama 2" gjatë konstituimit të saj në Kuvend.



Selia e PD-së

**AKUZA**

Në shkresën që i është dërguar organit të akuzës, demokratët pretendojnë se ka dyshime për fshehjen e të dhënave për aktivitet kriminal ndaj dy deputetëve, që sipas ligjit për dekriminalizimin duhej t'i pengonte për të marrë poste publike apo për t'u zgjedhur.

### Dokumenti, ndëshkimet dhe kufizimet e deputetëve

## PD-LSI, firmosin Kodin e ri të Etikës



PS-ja do ndërmarrë një nismë për hartimin e një kodi sjelljeje në Kuvend për deputetët, i cili do promovojë integritetin e tyre si dhe do i shërbejë luftës ndaj korrupsionit. Nisma është firmosur nga Hysi, Balla, Manja të PS-së dhe Petrit Vasili i LSI-së. "Kodi i sjelljes së deputetit promovon integritetin dhe deputeti nuk mund të ushtrojë aktivitete tregtare. Hartimi i një kodi sjelljeje do i shërbejë luftës ndaj korrupsionit. Akti do shërbejë për forcimin e besimit të parlamentit", - tha Balla. Mes të tjerash lexohet se, gjatë ushtrimit të mandatit deputeti duhet të mos lejojë që interesat e tij private të bien ndesh me pozitën e tij publike, të shmangë konfliktin e interesit dhe të mos shfrytëzojë pozitën për interesin e tij privat. Neni 6 përcakton që pikën e deklarimit dhe kontrollit të pasurive. Kufizime të tjera gjatë ushtrimit të mandatit janë: Vihet re se deputetit nuk i lejohet a) të jetë drejtues ose anëtar i organeve drejtuese të organizatave fitimprurëse; b) të ushtrojë veprimtari private, që krijon të ardhura në formën e personit fizik tregtar, ortakëri personash fizikë tregtarë të çdo forme, profesione të lira të avokatisë, të noterisë, ekspertit të licencuar. c) të zotërojë, në mënyrë aktive, asnjë aksion ose pjesë në kapital të një shoqërie tregtare, nëse ajo rezulton me pozitë dominuese në treg. Po ashtu, sipas rregullores, deputeti nuk mund të kërkojë ose të marrë në mënyrë të drejtpërdrejtë a të tërthortë dhurata, favore, premtime të cilat i jepen për shkak të pozicionit të tij nga një individ, person fizik ose juridik privat.

## SKANDALI NE FA

### LSI, Rama: Shefi i Shtabit, me gradë më të ulët se vartësit

LSI-ja përmes nënkryetarit Luan Rama denoncoi dje, një rast që sipas tij është paradoks, ndërsa lidhet me Forcat e Armatosura. Në një status në faqen e tij të "Facebook"-ut, Rama pohoi se shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë ka gradë më të ulët nga vartësit e tij. Me ironi Luan Rama shkruan se, me sa duket, është ndjekur 'parimi': Ta bëjmë gjeneral, për ta bërë shef shtabi. "Paradokse me autoritetet e komandimit në Forcat e Armatosura! Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, me gradë më të ulët nga vartësit e tij! Megjithëse në nenin 15, pika 2, të ligjit nr. 64/2014 "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit dhe të komandimit të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë", thuhet shprehimisht se 'Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura është autoriteti më i lartë ushtarak në gradë dhe në hierarkinë e drejtimit e të komandimit strategjik në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë', në fakt e vërteta nuk është kështu! Sepse, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, nuk është autoriteti më i lartë ushtarak në gradë!" - tha z. Rama.




**NJOFTIM PER SHITJE**

**Ne Zyren e Permbaruesit Gjyqesor Arjan Palla** me adrese Blv.Zogu i I-re,Pall.Agimi,H-2.K-3,Ap.-5-Tirane me dt. 10.10.2017 ora 16.00 zhvillohet ankandi per shitjen e pasurise me nr. 1/197 +3-26,vol8,fq.48,zk 8260,lloji I pasurise apartament me sip. 73 m2 ndodhur ne Tirane,rregjistruar ne pronesi te Fazile Stafa.Cmimi me te cilin fillon shitja eshte 40579,2 Euro.

**Njoftim**

**Permbaruesi gjyqesore Genti Bushati nxjerr per shitje ne ankand pasurine :**
"Apartament" me sip totale prej 73 m2 e rregjistruar ne rregjistrin hipotekore , vol 1 , faqe 195, me nr pasurie 2/413+1-17 , ne ZK 8592 me adrese Qyteti Shkoder" :....
Cmimi fillestare per shitjen ne ankand eshte ne masen **2,520,000 ( dymilione e peseqind e njezet mije) leke .**
Shitja e pasurise do te behet ( zhvillohet ) me date 16.10.2017 ora 16.16 ne Zyren e permbaruesit gjyqesore Genti Bushati me adrese Rruga Don Bosko , Perballe Gjykates se rrethit Gjyqesore Shkoder. Personat e interesuar duhet te derdhin perpara fillimit te ankandit 10 % te vleres si garanci ne Banken BKT dega Shkoder me nr llogarie 41064051, ose ne Tirana Bank me nr IBAN AL74 2065 1017 0000 6003 1383 9100 .

**Njoftim**

**Permbaruesi gjyqesore Genti Bushati nxjerr per shitje ne ankand pasurine :**
"Apartament" me sip 127.7 m2 , e rregjistruar ne rregjistrin hipotekore me nr 82 date 02.06.2011 me volumi 5 faqe 108 me nr pasurie 16/130+1-8, ne Zonen Kadastrale 8597 me adrese, lagjja "Pazare", Shkoder :
Cmimi fillestare per shitjen ne ankand eshte ne masen **3,472,000 (tremilione e katerqind e shtatedhjete e dy mije ) leke .**
Shitja e pasurise do te behet ( zhvillohet ) me date 13.10.2017 ora 16.16 ne Zyren e permbaruesit gjyqesore Genti Bushati me adrese Rruga Don Bosko , Perballe Gjykates se rrethit Gjyqesore Shkoder. Personat e interesuar duhet te derdhin perpara fillimit te ankandit 10 % te vleres si garanci ne Banken BKT dega Shkoder me nr llogarie 41064051, ose ne Tirana Bank me nr IBAN AL74 2065 1017 0000 6003 1383 9100 .



## Reagojnë partitë, PS: Institucionet duhet të bëjnë detyrën

# Mandati i deputetëve, Llalla takon Ramën: Po verifikojmë

## *Rakipi e Gjetani: Sulm politik, s'kemi precedentë penalë*

Darina Tanushi

Kërkesa e PD-së për t'u hequr mandatin dy deputetëve, të PS-së dhe të PDIU-së, vuri në lëvizje dje kryeministrin Edi Rama dhe kryeprokurorin Adriatik Llalla. Ata janë takuar dje, me kërkesë të kreut të qeverisë. Pas takimit, Prokuroria njoftoi se në fokus të takimit ishte diskutimi mbi kërkesën e Partisë Demokratike, lidhur me verifikimin e thelluar në kuadër të ligjit të njohur si "Për Dekriminalizimin", për deputetin e PDIU-së, Aqif Rakipi. Në takim, kryeprokurori Llalla shprehu garancitë e plota se Prokuroria e Përgjithshme do të vijojë të kryejë verifikimet e thelluara për të gjitha rastet që do i paraqiten me kërkesë të subjekteve të njohura nga ligji, si edhe me iniciativën e saj, kur informacioni sigurohet nga të dhënat që përpunon institucioni i Prokurorisë. Në njoftim mësohet se Prokuroria e Përgjithshme ka nisur verifikimin e thelluar ndaj deputetit Aqif Rakipi disa muaj më parë dhe se procedura e verifikimit për këtë subjekt është ende në zhvillim, "pasi Sektori i Posaçëm për 'Dekriminalizimin' në Prokurorinë e Përgjithshme është ende në pritje të përgjigjeve nga ana e disa prej autoriteteve të huaja, të cilave u është kërkuar informacion". Gjithashtu, Prokurori i Përgjithshëm theksoi se, po vijon bashkëpunimi me autoritetet e tjera që kanë për detyrë verifikimin paraprak të subjekteve të ligjit "Për dekriminalizimin", ku veçoi Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si institucioni që kryen përpunimin paraprak të personave të zgjedhur në pushtetin qendror dhe lokal. Nga ana e saj, PDIU-ja reagoi në mbrojtje të deputetit të saj, Aqif Rakipi, duke akuzuar Lulzim Bashën se dramën e humbjes së 25 qershorit kërkon ta transferojë diku tjetër. Sipas PDIU-së, Rakipi është verifikuar nga Interpoli dhe ky është mandati i tij i dytë. Ndërkohë, në formularin e vetëdeklarimit, të dy deputetët kanë firmosur se nuk kanë çështje të hapura në shtete të tjera. Sipas formularëve të dekriminalizimit, të dorëzuar nga vetë deputetët Rakipi e Gjetani, rezulton se dy deputetët nuk janë të dënuar dhe as në kërkim nga autoritetet e huaja apo ato shqiptare. Në pyetjen nëse ka jetuar jashtë shtetit për më shumë se një muaj, deputeti i PDIU-së, Aqif Rakipi i është përgjigjur pozitivisht, por nuk ka asnjë të dhënë tjetër që ai të jetë person me precedent penal, siç pretendon PD-ja. Që të dy deputetët i janë përgjigjur me "jo" pyetjes nëse janë dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj. Edhe deputeti tjetër i PS-së, Gjetan Gjetani e ka cilësuar shpifje, sulmin e PD-së. Nga ana e tij, kreu i Grupit Parlamentar të PS-së, Taulant Balla deklaroi dje, se ligji do të veprojë njëlloj mbi cilindo. Nga kryesia e Kuvendit, në përfundim të mbledhjes së Konferencës së Kryetarëve, kreu i grupit të PS-së deklaroi se nuk ka asnjë koment shtesë mbi kërkesën e PD-së, pasi janë institucionet përkatëse që bëjnë verifikimin e çdo deputeti. "Ligji është shumë i qartë dhe s'ka nevojë për mbështetje dhe institucionet duhet të bëjnë detyrën e tyre. Nuk kam asnjë koment shtesë për aq kohë sa institucionet e ngarkuara me ligj po merren me çështjen. Unë jam bashkëhartues i ligjit të dekriminalizimit; ligji ka hequr ndikimin tonë, janë institucionet përkatëse që merren me këtë. Procesi i verifikimit ka dy faza, para dhe pas zgjedhjes së deputetëve, ligji do respektohet për këdo qoftë ai", - tha Balla.



Kryeprokurori Adriatik Llalla

**TAULANT BALLA**

"Ligji është shumë i qartë dhe s'ka nevojë për mbështetje, dhe institucionet duhet të bëjnë detyrën e tyre. Nuk kam asnjë koment shtesë për aq kohë sa institucionet e ngarkuara me ligj po merren me çështjen. Unë jam bashkëhartues i ligjit të dekriminalizimit; ligji ka hequr ndikimin tonë, janë institucionet përkatëse që merren me këtë", - tha Balla.

**GJETAN GJETANI**



Deputeti socialist i qarkut të Lezhës, Gjetan Gjetani tha dje për median se nuk ka qenë kurrë në Itali. "Nuk jam njohur ende me kërkesën e PD-së. S'kam qenë kurrë në Itali dhe në asnjë vend jashtë", - deklaroi Gjetani, duke hedhur poshtë pretendimet e PD-së, në kërkesën për t'i hequr atij mandatin.

## Aqif Rakipi: Nuk kam asnjë problem me drejtësinë italiane

Deputeti i PDIU-së, Aqif Rakipi e cilësoi dje, "sulm politik" kërkesën e PD-së për t'i hequr mandatin e deputetit. "Unë s'di asgjë për këtë që po bën PD-ja, s'kam dijeni për këtë kërkesë. Nuk kam asgjë për këto që pretendojnë ata, pra s'kam asnjë problem me drejtësinë italiane. Janë thjesht sulme politike të PD-së, e cila gjithë kohën thotë të njëjtat gjëra. Le të hetojë kush të dojë për personin tim, do vijoj punën si deputet i qytetit të Elbasanit", - u shpreh deputeti i PDIU-së. "PD-ja të shohë kryetarin që ka vrarë 4 vetë në shesh", - tha Rakipi, duke sqaruar se opozita nuk mund ta ulë dot imazhin e tij. Nga ana e saj, edhe PDIU-ja në një deklaratë për mediat u shpreh se: "Z. Aqif Rakipi është verifikuar dhe stërverifikuar nga institucionet ligjzbatuese për dekriminalizimin dhe zyrtarisht Interpoli dhe Prokuroria kanë deklaruar se nuk ka të dhëna për implikimin e tij". "Ai është deputet për herë të dytë, me një mbështetje të madhe në Elbasan, dhe duket se kjo është halë në sy për Partinë Demokratike, që rrezikon të mbetet fuqi e tretë politike në atë qark. Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet i bën thirrje Lulzim Bashkës të mos transferojë problemet e brendshme diku tjetër dhe të mos vazhdojë me nenin e agjitacion-propagandës të komunizmit", thuhet nga PDIU-ja.



## Tahiri: Parlamenti nuk dëgjon, një racë e re dhunuesish po rritet

Ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri është kundër dhunuesve të kafshëve. Duke iu referuar një rasti ku një person dhunon një qen, ish-ministri Tahiri thotë se "një racë e re dhunuesish po rritet". Reagimi i Tahirit është edhe një tërheqje vëmendjeje ndaj parlamentit, pasi një vit më parë ai thotë se ka propozuar një projektligj për mbrojtjen e kafshëve nga dhuna, por që nuk ka ndryshuar. "Një racë e re dhunuesish po rritet. Sot me një qen, nesër me një shok a familjar, e kështu pa mbarim. Thuajse 1 vit më parë propozova një projektligj për mbrojtjen e kafshëve nga dhuna, por parlamenti nuk dëgjon. Më mbetet ta risjell përsëri në vëmendje, me shpresën se të gjithë ata që nga kjo e sotmja janë neveritur e frikësohen nga e ardhmja, të gjejnë kohë të bëhen bashkë e të detyrojnë parlamentin të marrë në shqyrtim e të miratojë një ligj për të ndalur përfundimisht masakrën ndaj kafshëve", shkroi dje, ish-ministri.



STRATI

Shoqëria përmbarimore **"STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k.**, njofton shpalljen për shitjen në ankand të pasurive të paluajtshme:

**-"Apartament" me sipërfaqe 62 m², me vendndodhje Lagjia "Kongresi i Elbasanit", Elbasan, regjistruar në pronësi të Kujtim Zhika, me Nr. Pasurie 5/27+4-2, Zona Kadastrale 8521, Volumi 11, Faqe 32, lënë si garanci bankës përmes kontratës së hipotekës Nr. 139 Rep., dhe Nr. 40/2 Kol., datë 19.01.2008.** Çmimi fillestar i ankandit është **28,123 Euro;**
**-"Ndërtesë" me sipërfaqe 15.5 m², me vendndodhje Lagjia "Kongresi i Elbasanit", Elbasan, regjistruar në pronësi të Lulieta dhe Sabiola Beqiraj, me Nr. Pasurie 5/61.** Çmimi fillestar i ankandit është **22,680 Euro.**

**Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 11.10.2017.**

**Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambjentet e Shoqërisë Përmbarimore "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7. Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com**

**SHPALLJE ANKANDI**

Shoqëria përmbarimore **"Corrector" shpk,** zhvillon ankandin e III-të, për shitjen e pasurisë së paluajtshme,
- Truall + Ndërtesë me sipërfaqe 116.2 m², nga e cila ndërtese me sipërfaqe 55 m², ndodhur ne Zonën Kadastrale 8562, Nr.Pasurie 2/966, Vol.31, Fq.105, e regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë; Cmimi i ankandit të tretë është EUR 45,360 (dyzetë e pesë mijë e treqind e gjashtëdhjetë euro).
Ankandi zhvillohet dt.30/10/2017, ora 16.00 në adresën, Rruga e Kavajes, Ndertesa 27, Hyrja 1, Kati i III –te, Tiranë.
**Kontakt: cel. 0684000061, ose në adresën e email: armels.lole@nchb.al**

"E vetmja rrugë për t'i bërë vendet tona më të sigurta"

# Haki Çako: Luftë pa kompromis ndaj krimit të organizuar dhe çdo forme tjetër të paligjshmërisë

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Haki Çako, paralajmëroi dje se do të ketë luftë të ashpër ndaj çdo kontingjenti kriminal në Shqipëri. Paralajmërimi i tij u bë gjatë konferencës rajonale të organizuar në Tiranë nga Qendra e INTERPOL dhe Departamenti Amerikan i Shtetit e Zyra e Narkotikëve. Numri një i Policisë së Shtetit tha se lufta ndaj krimit të organizuar do zhvillohet pa kompromis. "Shqipëria tashmë është një vend kandidat për në Bashkimin Europian. Pozita e saj gjeografike, por jo vetëm, na detyron të ashpërsojmë luftën ndaj krimit të organizuar dhe çdo forme tjetër dhe të sinkronizojmë punën me organizatat policore në rajon dhe vendet partnere, drejt përmbushjes së standardeve perëndimore. Ne jemi të qartë dhe të ndërgjegjshëm se kjo është e vetmja rrugë në luftën pa kompromise ndaj çdo organizimi kriminal, për t'i bërë vendet tona më të sigurta. Gjej rastin të shpreh bindjen se të gjithë përfaqësuesit që janë këtu, do të demonstrojnë aftësitë e tyre më të mira profesionale dhe njerëzore, për të konsoliduar bashkëpunimin si me punonjësit e Policisë Shqiptare, ashtu edhe me organizatat dhe agjencitë ndërkombëtare që na asistojnë, për të qenë të suksesshëm në luftën ndaj krimit dhe për t'u garantuar qytetarëve të vendeve tona prosperitet, siguri dhe besim", tha Çako. Konferenca është zhvilluar në vendin tonë që prej datës 2 e do të vijojë deri më 6 tetor. Qëllimi i konferencës është krijimi i Grupit Rajonal të Punës dhe ushtrimi praktik për bashkëpunimin me sektorin privat gjatë hetimeve kundër kontrabandimit të njerëzve në Ballkan, në kuadër të projektit të INTERPOL-it për rrjetin e specializuar operacional kundër kontrabandimit, mbështetur nga Zyra për Narkotikët dhe Agjencitë Ligjzbatuese Ndërkombëtare (INL), në Departamentin e Shtetit. Çako ka përgëzuar të gjithë pjesëmarrësit në këtë takim sensibilizues, në kuadër të rrjetit të krijuar nga INTERPOL-i, në lidhje me çështje kaq të ndjeshme, siç është migracioni i parregullt dhe trafikimi i qenieve njerëzore.


Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Haki Çako

Ngjarja në rrugën "Petro Nini", 55-vjeçarja: Ndihem e kërcënuar. Jetoj e vetme

# Pako me tritol pronares së dyqanit të rrobave, pesë muaj më parë i shpërthyen makinën

## Bruna Aliaj: Dyshoj për konkurrencë, s'kam konflikte me njeri

Xhensila Kodra

Një sasi tritoli e paaktivizuar iu vendos dje një dyqani rrobash, në rrugën "Petro Nini", në kryeqytet. Mësohet se pronarja e këtij biznesi është Bruneta Aliaj, e cila e konstatoi pakon e dyshimtë në hyrje të shkallëve që të çon në dyqanin e saj. Menjëherë, ajo njoftoi policinë se dyshonte se në pakon e vogël mund të ndodhej diçka e dyshimtë, që sipas saj mund të ishte një sasi tritoli. Pas kësaj telefonate, policia u vu në lëvizje. 5 muaj më parë, 55-vjeçares Aliaj iu vendos lëndë eksplozive në mjetin e saj "Smart", ku fatmirësisht nga shpërthimi nuk pati persona të lënduar. E shoqëruar në polici për t'u marrë në pyetje, 55-vjeçarja ka pohuar se sikundër herët e kaluar ku dyshonte se mund të ishte kërcënim nga ish-bashkëshorti, tashmë ka dyshime se ngjarjet mund të kenë lidhje për shkak të konkurrencës.

**NGJARJA**

Bruneta Aliaj e kishte konstatuar pakon e dyshimtë në shkallët e dyqanit mëngjesin e djeshëm sapo kishte shkuar për në punë. E frikësuar nga kjo situatë, duke marrë shkasë edhe nga rasti kur i shpërtheu mjeti në maj të këtij viti tek "9 Katëshet", 55-vjeçarja njoftoi uniformat blu. Të mbërritur menjëherë në vendin e ngjarjes, si dhe pas këqyrjes së kryer prej ekspertëve, u vu re se eksplozivi që ndodhej në pako nuk mund të shpërthente, pasi nuk kishte të aktivizuar kapsollën dhe detonatorin. Pakoja u administrua nga ekspertët, të cilët do të kërkojnë të gjejnë shenja gishtash, por edhe të mbetjeve biologjike për të identifikuar autorët e kësaj ngjarjeje, ndërsa janë sekuestruar edhe një sërë pamjesh filmike të kësaj zone. "Rreth orës 10:37, jemi njoftuar se në një dyqan rrobash në rrugën 'Petro Nini' pretendohet se është vendosur një pako në dukje si eksploziv. Në vendngjarje kanë mbërritur shërbimet e policisë, ku nga verifikimet paraprake rezulton se shtetasja B.A., pretendon se në dyqanin e saj të rrobave, në rrugën 'Petro Nini', i kanë vendosur një pako në dukje si eksploziv. Është rrethuar vendi i ngjarjes dhe është njoftuar njësia antieksploziv", tha zyrtarisht policia.

**DËSHMIA**

E marrë në pyetje nga hetuesit e çështjes, 55-vjeçarja ka pohuar se nuk ka dijeni për autorët, pasi nuk ka konflikte me njeri. "Dyshoj se ngjarja mund të jetë përsëritur për shkak të konkurrencës", mësohet të ketë thënë Bruneta Aliaj, teksa hedh poshtë faktin se mund të ketë pasur gisht ish-burri i saj me të cilin ka disa vite që është divorcuar. 55-vjeçarja ka deklaruar më tej se duke qenë se autorët që i shpërthyen makinën 5 muaj më parë nuk janë zbuluar ende, ajo tashmë ndihet e rrezikuar. "Unë jetoj e vetme. Personat që më vendosën tritolin në makinë nuk janë kapur akoma. Sot (dje) po e njëjta situatë. Po ndihem e kërcënuar për shkak të këtyre situatave", ka rrëfyer ajo më tej. Sakaq, policia ka dyshime se të dyja ngjarjet kanë lidhje me njëra-tjetrën dhe se autori mund të ketë qenë i njëjtë, si dhe janë duke verifikuar ndonjë konflikt të mundshëm që mund të ketë tregtarja 55-vjeçare.


Bruna Aliaj


Dyqani ku u gjet tritoli

**SHPËRTHIMI I MAKINËS**

Më 2 maj të këtij viti, vetura tip "Smart" në pronësi të Bruneta Aliajt shpërtheu pasi i ishte vënë një sasi eksplozivi. Ngjarja ndodhi në zonën e "9-Katësheve", pa lënduar njerëz. 55-vjeçarja e kishte parkuar mjetin poshtë pallatit të saj, ndërsa 5 muaj më parë ka deklaruar në polici se me të vetmin person që ka pasur konflikte për shkak të divorcit ka qenë ish-bashkëshorti i saj.

Sherri nisi për motive të dobëta

# Babai plagos me thikë të birin, policia arreston 57-vjeçarni

Krimi në familje tron diti kryeqytetit mbrëmjen e djeshme. Burime pranë policisë bënë me dije se një 20-vjeçar u plagos me thikë nga babi i tij, ndërsa ky i fundit u prangos menjëherë nga policia. I lënduar ka mbetur shtetasi me iniciale O.Ç., ndërsa policia arrestoi në flagrancë 57-vjeçarin Bujar Çika. Ngjarja u shënua rreth orës 20:35 minuta në banesën e tyre, ndërsa shkak i plagosjes ka qenë një konflikt mes tyre për motive të dobëta. "Rreth orës 20:35 jemi njoftuar se në rrugën 'Behlul Hatibi', një shtetas është goditur me thikë nga i ati. Në vendngjarje kanë mbërritur shërbimet e policisë dhe ambulanca, ku nga verifikimet paraprake ka rezultuar se shtetasi O.Ç., 20 vjeç, pas një konflikti për motive të dobëta, në banesë është goditur me thikë nga i ati, shtetasi Bujar Çika, 57 vjeç. Shtetasi i dëmtuar, O.Ç. ndodhet në spital nën kujdesin e mjekëve, jashtë rrezikut për jetën. Shtetasi Bujar Çika është shoqëruar në ambientet e policisë për veprime të mëtejshme", thuhej në njoftimin e policisë. Sakaq, burime pranë uniformave blu sqaruan se sherri mes tyre ka nisur për konfliktet familjare, pasi 57-vjeçari shpeshherë i kërkonte të birit të mos shkonte vonë në banesë dhe të mos i shkaktonte konflikte me njeri.



**INTERVISTA/** "Tim bir e dhunuan në mënyrë makabre derisa i ra të fikët e pësoi vdekje klinike"

# Vrasja e Ibrahim Bashës, Ilirjan Malo: Djali im është i pafajshëm, të lirohet

Ina Allkanjari

## *"Xhuliano njihej vetëm me Albanon, s'e di si u ndodh në Lazarat"*


Xhuliano Malo


Të akuzuarit pë sulmin e Lazaratit në gjyq

"Djali im është i pafajshëm. Ai nuk është i përfshirë në sulmin me armë ku u vra Ibrahim Basha. Ne jemi nga Gjirokastra dhe nuk e di se si ai u gjend në Lazarat. Unë e dija që Xhuljano ndodhej në lagje". Kështu deklaroi dje, në një intervistë ekskluzive për "Gazeta Shqiptare" Ilirjan Malo, babai i të pandehurit Xhuliano Malo. Ky i fundit dyshohet të jetë njëri prej të pandehurve që mori pjesë në sulmin me armë ndaj policisë në Lazarat në qershor të 2015-ës, ku u vra edhe efektivi i RENEA-s, Ibrahim Basha. Ilirjan Malo hodhi akuza ndaj policisë, duke thënë se, në momentet e para që i biri është marrë në pyetje, është dhunuar. "Djalit i kishin bërë presion psikologjik dhe e kishin rrahur, kishin ushtruar dhunë makabre, aq sa e dërguan për në spitalin e Gjirokastrës pasi i ra të fikët dhe pësoi vdekje klinike", tha ai. Ndërkaq, dje në Gjykatën e Krimeve të Rënda u zhvillua seanca e radhës ndaj 11 të akuzuarve për sulmin në Lazarat dhe vrasjen e Ibrahim Bashës, ku Ilirjan Malo deklaroi në mbrojtje të të birit. Në intervistën për "Gazeta Shqiptare", Malo tregon se si e mori vesh për arrestimin e të birit, duke pretenduar mospërfshirjen e Xhulianos në një organizatë kriminale.

**Zoti Ilirjan, djali juaj akuzohet se ka marrë pjesë në sulmin me armë në Lazarat dy vite me parë, ku vdiq efektivi i RENEA-s, Ibrahim Basha. A ishit në dijeni se ku ndodhej Xhulio ditën e ngjarjes?**

Nuk e kuptoj si u gjend Xhulio në Lazarat. Ne jetojmë në Gjirokastër. Djali në mëngjes ishte në shtëpi dhe nuk kisha dijeni që ishte larguar për në Lazarat, pasi mendova se ishte në lagje. Ai ishte adoleshent kur ndodhi ngjarja, ishte vetëm 17 vjeç. Nuk ka lidhje me sulmin. Ai u gjend në vendin e gabuar dhe në kohën e gabuar.

**Si u njoftuat për arrestimin e djalit?**

E mora vesh nga lajmet, më pas më kontaktoi një oficer policie. Sapo e kuptova çfarë kishte ndodhur, shkova menjëherë në rajonin e policisë, ku më morën edhe në pyetje. Ata u treguan të pabesë; unë kam qenë ushtarak dhe shumë prej tyre i njoh, por ditën e arrestimit nuk më lanë as që të isha i pranishëm në momentin që morën në pyetje tim biri, i cili ishte nën moshë. Ndërkohë që më pyesnin, dëgjoja britmat e tim biri.

**Mendoni se e kanë dhunuar për të treguar çfarë dinte?**

Mësova që djalit i kishin bërë presion psikologjik dhe e kishin rrahur, kishin ushtruar dhunë makabre, aq sa e dërguan për në spitalin e Gjirokastrës pasi i ra të fikët dhe pësoi vdekje klinike. Ndërkohë, sipas procesverbaleve, deklarimet e Xhulios rezultojnë në orën 10:00, por djali është përmendur dhe ka dhënë deklarime në orën 4:00.

**Kush ishte prezent gjatë deklaratës së Xhulios, kishit siguruar një avokat?**

Të gjithë u treguan të pabesë, sepse kur djali dha deklaratën, ka qenë prezente psikologia, e cila i ka thënë Xhulios "nuk ka problem mund ta firmosësh", ndërkohë që brenda kishte qenë edhe një avokat i prezantuar sikur ishte i familjes, por ne nuk e njihnim atë. Pasi kishte firmosur djali, asnjë nuk më dha asnjë shpjegim. Psikologia më tha vetëm "sill rroba për Xhulion sepse do i duhen që të ndërrohet". Nga kjo e kuptova që situata ishte e rëndë. Por djali është i pafajshëm, vetë prokuroria e ka përfshirë në këtë ngjarje.

**Në dijeninë tuaj, a kishte njohje Xhuliano me personat e tjerë që janë arrestuar në lidhje me sulmin?**

Ne jemi nga Gjirokastra dhe me origjinë nga Tepelena. Djali shokët i ka qytetarë, nuk i njeh djemtë e tjerë që po akuzohen për sulmin, as ata nuk e njohin tim bir. Shokët e tij janë shokët e shkollës. Si mund të jetë pjesë e një organizate kriminale një 17-vjeccar kur im bir nuk e dinte çfarë është një organizatë?!

**Më herët Xhuljano ka deklaruar se i njeh personat e arrestuar. Çfarë reagimi keni në lidhje me këtë fakt?**

Nga ata persona, djali im njihte vetëm Albanin. Kanë qenë në një shkollë bashkë. Djali im nuk i njeh personat e arrestuar, por mendoj se atë deklaratë ai e ka bërë duke qenë nën presion.

**Kur jeni takuar me Xhulianon në burg, çfarë ju ka treguar?**

Kur e kam takuar, ndodhej në ankth. Djali më ka thënë se është i pafajshëm dhe e kanë arrestuar kot.

**Sot (dje) ju dëshmuat në Gjykatën e Krimeve të Rënda në seancën e radhës të zhvilluar ndaj djalit tuaj dhe të pandehurve të tjerë. Çfarë deklaruat?**

Mbrojta pafajësinë e djalit tim, pasi duhet të dalë e vërteta. Unë kam dy vajza dhe Xhulion e kam djalë të vetëm. Kam ardhur në Tiranë dhe çdo javë e takoj tim bir dhe e theksoj: ai është i pafajshëm. Sapo kishte mbyllur vitin e dytë të gjimnazit kur ma arrestuan. Po i humbet e ardhmja. Xhulio nuk ka lidhje me atë sulm dhe ai duhet të lirohet dhe të vazhdojë jetën. Ka dy vjet e 4 muaj që lëviz nga burgu i Kavajës tek ai i Fushë-Krujës. Kërkoj të drejtën për tim bir.

**Çështja e tyre po gjykohet nga e para. A keni ndonjë thirrje ndaj institucioneve të drejtësisë?**

Drejtësia duhet të vihet në vend dhe personat përgjegjës të dënohen për atë që kanë bërë. I bëj thirrje edhe prokurorisë që ta shohë çështjen me më shumë përparësi, sepse unë jam i bindur që im bir është i pafajshëm.

---

**Regjistrohen 694 procedime penale në fushën e drogës**

## Raport për antihashashin, ekspertët e Bashkimit Europian mbledhin të dhënat



Me vendim të Këshillit të Ministrave, anëtarë të Task Forcës kundër kanabisit po raportojnë para ekspertëve të Bashkimit Europian për masat e marra dhe luftën kundër drogës në vend. Për këtë arsye janë gjendur dje pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda shefi i Prokurorisë Publike në Suedi, Mats Sallstrom dhe prokurori i Antimafias se Napolit, Michelle Fini. Mësohet se nuk kanë munguar zyrtarë të Antidrogës në Policinë e Shtetit, prokurorë të Krimeve të Rënda, kreu i Krimeve të Rënda Besim Hajdarmataj, si edhe drejtori i hetimit në Prokurorinë e Përgjithshme, Adnan Xholi, gjithashtu përfaqësues i Task Forcës qendrore. Pjesëtarët e prokurorisë raportuan për gjashtë muajt e parë të 2017-ës dhe mësohet se janë regjistruar 694 procedime penale në fushën e drogës, ku kryeson prodhimi dhe shitja e narkotikeve. "Ne kemi mbështetur policinë", ka deklaruar gjatë takimit, Adnand Xholi në kërkesat për përdorimin e metodave speciale të hetimit të këtyre rasteve, ndërsa ka një bashkëpunim të fortë edhe me shërbimet e inteligjencës për identifikimin e personave ndaj të cilëve dyshohet se janë implikuar dhe vijojnë këtë aktivitet të paligjshëm.

---

**Mashtroi familjen e viktimës 4 vite më parë**

## Përvetësoi 2.7 milionë lekë, gjykata lë në burg avokatin


Myrteza Myftari

Gjykata e Tiranës caktoi dje masën e sigurisë "arrest me burg" për avokatin Myrteza Myftari. 56-vjeçari, banues në kryeqytet, ra në pranga pak ditë më parë pasi nuk iu dha dëmshpërblimin e përfituar nga aksidenti familjarëve të viktimës. Shtetasi M.S. ka bërë kallëzim në zyrat e Antikrimit Ekonomik të Tiranës kundrejt avokatit, ku deklaroi se shtetasi Myrteza Myftari, me profesion avokat, më datë 02.05.2013 ka marrë një shumë rreth 2.7 milionë lekë të reja. Shumë e marrë kjo si dëmshpërblim nga kompania e sigurimit për dëmin shëndetësor me pasojë vdekjen e shtetasit F.R.. Sipas shtetasit M.S., i dyshuari e kishte marrë këtë shumë rreth 4 vite më parë dhe nuk ua ka dhënë, duke e përfituar vetë dëmshpërblimin që i takonte familjes. Mësohet se ngjarja ka ndodhur në 2013-ën, kur një kalimtar, shtetasi me iniciale F.R., është përplasur për vdekje nga një automjet. Avokati akuzohet për veprat penale "Shpërdorim detyre" dhe "Mashtrim".

Eksperti i arsimit: Raporti vlerësues duhej bërë publik pasi të konsultohej me senatin

# Zhapaj: Qeveria përpiqet të shndërrojë në "kioskë" UT

## "Po ulet figura e universitetit te maturantët"

Voltiza Duro

Disa ditë më parë, raporti britanik publikoi rezultatet mbi cilësinë e universiteteve shtetërore e private në vend, ku Universiteti i Tiranës u vlerësua minimalisht. Pas kësaj, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë vendoi t'i japë vetëm 1 vit akreditim UT-së dhe Bordi i Akreditimit listoi një sërë rekomandimesh për këtë institucion të arsimit të lartë. Por, në lidhje me çështjen, nuk kanë munguar reagimet e replikat mes drejtuesve të fakulteteve të UT-së e specialistëve përkatës. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Albano Zhapaj, ekspert i arsimit të lartë tregon se publikimi i këtij raporti është i qëllimshëm për të goditur imazhin e universitetit më të madh në vend.


Albano Zhapaj

**Raporti britanik e vlerësoi minimalisht Universitetin e Tiranës. Cili është qëndrimi juaj mbi këtë vlerësim?**

Bërja publike e raportit paraprak të vlerësimit të grupit të punës për akreditimin e Universitetit të Tiranës nuk është aspak rastësore. Përkimi i saj pikërisht në datat e mbyljes së fazës së parë të regjistrimeve në universitete ka ndodhur për të goditur UT-në si institucionin më të madh shtetëror në vend të arsimit të lartë. Qeveria përpiqet të shndërrojë në "kioskë" UT-në.

**Sipas jush, kur duhej publikuar ky raport?**

Raporti paraprak i akreditimit, si rregull, theksohej se në asnjë rast nuk duhej bërë publik, pa u konsultuar më parë me senatin akademik të Universitetit të Tiranës. Por diçka e tillë nuk ndodhi, e këta të fundit e lexuan dhe u informuan nëpërmjet medias mbi vlerësimin e këtij raportit dhe jo në rrugë zyrtare.

**Sa besoni në saktësinë e raportit britanik?**

Ky raport paraprak ka gjasa të jetë hartuar në ndonjë zyrë shtetërore dhe jo nga një grup vlerësuesish seriozë, ashtu si kërkon ta "shesë" veten agjencia britanike. Por kam bindjen se kjo e vërtetë do të dalë në shesh, por deri atëherë do të kenë përfunduar regjistrimet në universitetet klienteliste të qeverisë, të cilët lindën dhe u zhvilluan falë kapaciteteve akademike të huazuara dhe formuara pikërisht në atë universitet siç është UT, që kaq fort po e godasin dhe po e ulin imazhin e tij.

**Si ndikon rezultati i raportit mbi imazhin që maturantët krijojnë për UT-në?**

Për të gjithë maturantët që dëshirojnë të studiojnë në institucionet e arsimit të lartë, krijohet ideja që ul figurën e UT-së dhe ata nuk e shohin si një institucion të vlefshëm për të kryer studimet. Logjikisht, kuptohet se përse në të njëjtën periudhë u bënë disa deklarata publike kundër arsimit të lartë në UT. Duke qenë se udhëzimi i MAS për fazën e parë kishte detyrimin e regjistrimit për studentet fitues në degët përkatëse, shumë maturantë mbajtën degët e fituara, pasi në raundin e dytë u hiqej e drejta për të konkurruar nëse nuk regjistroheshin.

**Cili është vlerësimi juaj për Universitetin e Tiranës?**

Në gjykimin tim, Universiteti i Tiranës është dhe do të mbetet institucioni më i mirë i arsimit të lartë në vend, pasi ofron kapacitete njerëzore dhe akademike të përgatitura për brezat që studiojnë aty.

## Goci: Po manipulojnë studentët

### Pedagogu: Kjo është një "lojë" për shkatërrimin e imazhit të UT

Ervin Goci, pedagog në departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit në Universitetin e Tiranës, në një prononcim për "Gazeta Shqiptare" tregon se kjo është një lojë marrëdhëniesh me publikun për të shkatërruar imazhin e UT-së, me qëllim manipulimin e studentëve, të cilët do të mendojnë se po shkojnë në një universitet më të mirë. "Ne kemi kërkuar një analizë të thelluar të gjendjes së Universitetit të Tiranës dhe më gjerë dhe pastaj do kishte kuptim matja. Nuk mundet që pikërisht në momentin që vetë pedagogët, me shumë dinjitet janë duke kërkuar një reformë tërësore, pikërisht për shkak se gjendja është e rëndë, të kryesh një proces rutinor matjeje me një rezultat që të gjithë e dinim. Aty dalin të gjitha problemet e administrimit të një strukture të menaxhuar në mënyrë hierarkike, madje autoritare, pa autonomi reale, kështu që ata që e kanë porositur matjen, nuk kanë bërë gjë tjetër, veçse kanë matur performancën e punës së tyre", - thotë pedagogu për 'GSH'. Ai shprehet se Universiteti i Tiranës është një makineri gjigante, me parime themelimi dhe funksionimi që nuk kanë të krahasuar. "Paradoksi arrin kulmin në momentin që UT-ja ka bërë akreditimet e licencave, programeve, kurrikulave të disa universiteteve që sot renditen për cilësi më mirë se ky universitet. Kjo është absurde", - thekson Goci.


Ervin Goci

## Raundi i dytë, Farmacia 3 fitues, Shëndeti Publik 13

# Shpallen emrat e kandidatëve që transferohen në Universitetin e Mjekësisë

Fakulteti i Mjekësisë ka publikuar emrat fitues për raundin e dytë në garën për universitete. Specifikisht në programin e studimit Farmaci janë shpallur vetëm 3 fitues nga kuotat e ngelura boshe në raundin paraardhës, ndërsa në degën Shëndet Publik, 13 studentë fitues nga 254 aplikime.

**TRANSFERIMET**

Komisioni i ekspertëve në Universitetin e Mjekësisë ka publikuar emrat e kandidatëve që kanë të drejtë të bëjnë transferimin e studimeve në këtë institucion për vitin e ri akademik 2017-2018. "Gazeta Shqiptare" publikon sot listat e studentëve që tashmë janë shpallur fitues për të qenë pjesë e UM. Në programin e studimit Mjekësi e Përgjithshme, 26 studentë kanë të drejtë të transferohen në këtë degë, pas verifikimeve përkatëse të kërkesave. Ndërsa të gjithë ata aplikantë që nuk janë pranuar, nuk kanë mundur të sigurojnë kreditet e nevojshme për lëndët që kanë zhvilluar në institucione të tjera gjatë vitit paraardhës. Gjithashtu, Universiteti i Mjekësisë ka publikuar edhe listën e emrave të kandidatëve që mund të transferojnë studimet në këtë institucion të arsimit të lartë, për nivelin "Master Shkencor", në programin e studimit Farmaci. Transferimi i studimeve do të lejohet vetëm ndërmjet programeve të të njëjtit cikël studimesh, pasi vetëm në këtë mënyrë bëhet vlerësimi i duhur i programeve të lëndës, si dhe krediteve të fituara nga studenti që kërkon të transferojë vitin studimor. Studentët që transferojnë studimet nga një program studimi apo nga programe të mëparshme studimi të ciklit të parë në një program tjetër studimi në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen tarifës së përgjithshme vjetore të shkollimit të programit të studimit përkatës, në të cilin ata kanë kërkuar të transferojnë studimet.


Universiteti i Mjekësisë

RENDITJA E APIKANTEVE PER TRANSFERIM NE MJEKESI TE PERGJITHSHME 2017-2018

| Nr. | Emër | Mbiemër | Viti i studimit i ndjekur ne vitin akademik 2016-2017 | Emërtimi i programit te studimit në të cilin transferohet dhe lloji (bachelor/PICD) | Viti i studimit ku transferohet | Pikët totale | Statusi i kandidatit fitues/jofitues |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Aida | Alimadhi | 2 | Mjekesi e pergjithshme | 3 | 845.4166667 | fitues |
| 2 | Livia | Bozhiqi | 2 | Mjekesi e pergjithshme | 2 | 767.4166667 | fitues |
| 3 | Glori | Prifti | 2 | Mjekesi e pergjithshme | 3 | 756.75 | fitues |
| 4 | Arberesha | Sabedini | 1 | Mjekesi e pergjithshme | 2 | 754.0833333 | fitues |
| 5 | Elio | Veliu | 3 | Mjekesi e pergjithshme | 3 | 751.3611111 | fitues |
| 6 | Ester | Ndreu | 1 | Mjekesi e pergjithshme | 2 | 748.0833333 | fitues |
| 7 | Kaltra | Matraku | 1 | Mjekesi e pergjithshme | 2 | 718.8333333 | fitues |
| 8 | Arbana | Aliu | 1 | Mjekesi e pergjithshme | 2 | 716.3333333 | fitues |
| 9 | Rinore | Ajdini | 1 | Mjekesi e pergjithshme | 2 | 703.5 | fitues |
| 10 | Soven | Sheme | 1 | Mjekesi e pergjithshme | 2 | 664.5 | fitues |
| 11 | Redi | Krimce | 2 | Mjekesi e pergjithshme | 2 | 655.5 | fitues |
| 12 | Elvis | Stojani | 3 | Mjekesi e pergjithshme | 2 | 633.7222222 | fitues |
| 13 | Ilia | Cepa | 1 | Mjekesi e pergjithshme | 2 | 628.75 | fitues |
| 14 | Aurel | Dezhgiu | 3 | Mjekesi e pergjithshme | 2 | 606.7777778 | fitues |
| 15 | Stesi | Bani | 2 | Mjekesi e pergjithshme | 2 | 600.4166667 | fitues |
| 16 | Xhesika | Habilaj | 2 | Mjekesi e pergjithshme | 2 | 586.4166667 | fitues |
| 17 | Kejdi | Domi | 3 | Mjekesi e pergjithshme | 2 | 585.0555556 | fitues |
| 18 | Arben | Zeka | 2 | Mjekesi e pergjithshme | 3 | 584 | fitues |
| 19 | Desara | Arapi | 2 | Mjekesi e pergjithshme | 2 | 578.6666667 | fitues |
| 20 | Rudina | Jakupi | 6 | Mjekesi e pergjithshme | 3 | 569.7777778 | fitues |
| 21 | Ambra | Mokreri | 2 | Mjekesi e pergjithshme | 2 | 549.4166667 | fitues |
| 22 | Sara | Sallaku | 2 | Mjekesi e pergjithshme | 2 | 534.1666667 | fitues |
| 23 | Arlend | Hoxha | 2 | Mjekesi e pergjithshme | 2 | 525.9166667 | fitues |
| 24 | Diamanta | Shameti | 3 | Mjekesi e pergjithshme | 2 | 508.8611111 | fitues |
| 25 | Alen | Tollumbi | 5 | Mjekesi e pergjithshme | 2 | 443.1666667 | fitues |
| 26 | Ljejalje | Selimi | 2 | Mjekesi e pergjithshme | 2 | 406.25 | fitues |
| 27 | Aliona | Como | 1 | Mjekesi e pergjithshme | | | jo fitues |
| 28 | Eda | Hoti | 1 | Mjekesi e pergjithshme | | | jo fitues |
| 29 | Edison | Tushaj | 3 | Mjekesi e pergjithshme | | | jo fitues |

LISTA E KANDIDATEVE PER TRANSFERIM STUDIMESH

| Nr. | Emer | Atesi | Mbiemer | Viti i studimit që ka | Emertimi I programit te studimit ku transferohet | Piket totale | Viti i Studimit ku transfer | Statusi i kualifikimit |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | AVNI | SYRJA | MEHILLI | VITI II | Master i Shkencave ne Farmaci | 530.5 | III | Fitues |
| 2 | ADELA | TAHIR | CANAJ | Viti I | Master i Shkencave ne Farmaci | 528.25 | II | Fitues |
| 3 | ELONA | ARTAN | HOXHA | Viti I | Master i Shkencave ne Farmaci | 528.25 | II | Fitues |
| 4 | MINERVA | YLLI | MEZINI | Viti II | Master i Shkencave ne Farmaci | 524.9166667 | III | Fitues |
| 5 | ERA | ARTUR | MEMINAJ | Viti III | Master i Shkencave ne Farmaci | 508.1944444 | IV | Fitues |
| 6 | DESHIRA | LAVDI | PULA | Viti I | Master i Shkencave ne Farmaci | 505.5 | II | Fitues |
| 7 | ALEKSANDER | MAKSIM | NAKO | Viti III | Master i Shkencave ne Farmaci | 497.1666667 | IV | Fitues |
| 8 | BETI | IVAN | FABER | Viti I | Master i Shkencave ne Farmaci | 495.25 | II | Fitues |
| 9 | ANXHELINA | PROLETAR | GRIPSHI | Viti I | Master i Shkencave ne Farmaci | 484 | II | Fitues |
| 10 | VIOLETA | ZEF | DODA | Viti II | Master i Shkencave ne Farmaci | 479.4166667 | III | Fitues |
| 11 | MEGI | ARTUR | MESONJESI | Viti I | Master i Shkencave ne Farmaci | 478.5 | II | Fitues |
| 12 | XHULJA | SIHAT | GJELI | Viti I | Master i Shkencave ne Farmaci | 469.5 | II | Fitues |
| 13 | JONA | ARTAN | PRIFTI | VITI I | Master i Shkencave ne Farmaci | 468.3333333 | II | Fitues |
| 14 | ENDRI | AGIM | STAFA | Viti I | Master i Shkencave ne Farmaci | 453.25 | II | Fitues |
| 15 | DAJAN | JANI | NIKA | Viti III | Master i Shkencave ne Farmaci | 445.9444444 | IV | Fitues |
| 16 | LIVIA | VIKTOR | NUHAJ | Viti II | Master i Shkencave ne Farmaci | 444.1666667 | III | Fitues |
| 17 | PIERO | REFKI | PERE | VITI I | Master i Shkencave ne Farmaci | 443.3333333 | II | Fitues |
| 18 | GABRIELA | SINAN | TORRAJ | VITI I | Master i Shkencave ne Farmaci | 436 | II | Fitues |
| 19 | IRLI | SPARTAK | CAKA | VITI I | Master i Shkencave ne Farmaci | | | Skualifikohet |

PENSIONET

DOKUMENTACIONI

Si përllogaritet masa e pagesës, jetimët shpërblehen për të dy prindërit e vdekur

# Pensionet familjare, ja kush përfiton

## Publikohen kriteret dhe dokumentacioni që nevojitet

Voltiza Duro

Të gjithë qytetarët që plotësojnë kriteret e paracaktuara në bazë të ligjit "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", kanë të drejtën e përfitimit të pensionit familjar. "Gazeta Shqiptare" publikon sot të gjitha kushtet dhe dokumentacionin që nevojitet për të marrë këtë pension si dhe mënyrën e përllogaritjes së masës së përfitimit. Fillimisht, individët e interesuar duhet të paraqiten pranë zyrave të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe të tërheqin formularin për të vijuar më tej me aplikimin. Nga ky pension, mund të përfitojnë të gjithë ata jetimë të moshës 18-25 vjeç që studiojnë apo janë të paaftë për punë. E në rastet kur një person humb të dy prindërit, i lind e drejta për të marrë pension jetimi për secilin prej tyre. Masa e pensionit për jetimin është 50% e pensionit, në kushtet kur e veja nuk është pjesëtare e pensionit familjar, dhe përfitues është vetëm ai.

### KUSHTET

Pension familjar mund të përfitojë e veja që është mbajtëse e një fëmije që ishte në ngarkim të të vdekurit, deri në moshën 8 vjeç; që nuk është e aftë të punojë dhe që ka mbushur moshën 55 vjeç. Gjithashtu, nga kjo kategori pensioni përfiton edhe burri i ve, kur është mbajtës i një fëmije që ishte në ngarkim të të vdekurit, deri në moshën 8 vjeç, që është i paaftë për punë dhe që ka mbushur moshën 60 vjeç. Të gjithë ata jetimë që ishin në ngarkim të personit që vdiq dhe janë nën 18 vjeç, ose deri në 25 vjeç, të cilët studiojnë apo janë të paaftë për punë mund të përfitojnë pension familjar. Një kategori tjetër që plotëson kushtet, janë edhe prindërit, kur kanë arritur moshën 65 vjeç ose janë të paaftë për punë, prindërit e prindërve, njerku e njerka, kur nuk kanë persona që detyrohen t'i mbajnë, nëse provohet se ata jetonin në të njëjtën familje me atë që vdiq, jo më pak se një vit para momentit të vdekjes dhe kanë arritur moshën 65 vjeç, ose janë të paaftë për punë. Edhe nipërit e mbesat, kur janë në ngarkim të atij që vdiq dhe bënin pjesë në të njëjtën familje me të, trajtohen si jetimë dhe mund të marrin pension familjar. Në momentin që i/e veja martohen sërish, e humbasin të drejtën e përfitimit të pensionit familjar.

### MASA E PËRFITIMIT

Pension familjar konsiderohet ai pension që kishte apo i takonte të ndjerit. Në kushtet kur e veja nuk është pjesëtare e pensionit familjar, dhe përfitues është vetëm një jetim, masa e pensionit për jetimin është 50% e pensionit që gëzonte ose do të gëzonte i ndjeri, ndërsa kur përfitues janë dy ose më shumë persona dhe e veja nuk është pjesëtare e pensionit familjar, masa e pensionit familjar për secilin prej tyre është 25%, por jo më shumë se 50% e pensionit që gëzonte ose do të gëzonte i ndjeri. Ndërkaq, personi i ve merr 50% të pensionit që gëzonte ose do të gëzonte i ndieri kur është i vetëm, dhe për çdo pjesëtar tjetër merr 25%, me kusht që shuma e pensionit të mos kalojë 100% masën e tij. Vlen të theksohet fakti se shuma e një pensioni familjar nuk duhet të kalojë masën e pensionit që merrte ose do të merrte personi që vdes. Në të gjitha ato raste kur prindi që jeton është i punësuar, është ekonomikisht aktiv ose merr një pension si të drejtë të tij, fëmija jetim përfiton pension familjar. Në këtë rast, masa e pensionit për çdo jetim ose person tjetër që përfiton është 25% e pensionit që i takonte të ndjerit, por jo më tepër se 50% e tij. Ndërsa jetimi i cili humb të dy prindërit, ka të drejtë të marrë një pension jetimi për secilin prej tyre. Në kohën kur përfundon afati i pagesës, përfituesi duhet të bëjë një kërkesë pranë ALSSH-së së vendbanimit për vazhdimin e pensionit familjar. Bashkëngjitur me kërkesën, i interesuari duhet të paraqesë edhe dokumentacionin përkatës.

### DOKUMENTACIONI

Të gjithë ata individë që do të aplikojnë për të fituar të drejtën e përfitimit të pensionit familjar, përveç kërkesës, duhet të dorëzojnë edhe dokumentet që vërtetojnë moshën dhe identitetin. Respektivisht ata duhet të paraqesin certifikatën e gjendjes familjare, fotokopjen e letrës së njoftimit elektronik për kërkuesin, ose përfituesit e tjerë, si dhe certifikatën e vdekjes së të ndjerit në të cilën duhet të jetë shënuar edhe shkaku i vdekjes. Gjithashtu, aplikuesi për pension familjar duhet të dorëzojë edhe dokumentet që vërtetojnë periudhat e sigurimit dhe llojin e punës, si libreza e punës apo vërtetimi për vjetërsinë në punë dhe llojin e saj. Bashkëngjitur dokumentacionit të mësipërm, duhet të dorëzohen edhe dokumentet që vërtetojnë të qenët në ngarkim të të ndierit si dhe: vërtetim i vazhdimit të shkollës për jetimët që kanë mbushur moshën ligjore për t'u punësuar ose vetëpunësuar, vërtetim që në ngarkim të të vdekurit ishte një i ve, që mban një fëmijë deri në moshën 8 vjeç, vërtetim për personin e ve, që është kërkues për punë, vendim i KMCAP-it për paaftësinë në punë të personave të familjes në ngarkim të të siguruarit të vdekur, kur ata janë në moshë pune etj. Nënvizojmë se në kërkesën për pension familjar, jetimi që ka moshën ligjore për t'u punësuar, kur nuk vazhdon shkollën, duhet të paraqesë vërtetim nga Zyra e Punës. Edhe vërtetimi i pagës duhet të përfshihet në dosjen e dokumenteve si dhe vërtetimi i pagës mesatare neto, për vitin e fundit të punës. Ndërsa të gjithë ata persona që përfitojnë nga ligji "Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve Politikë" duhet të dorëzojnë vërtetimin e gjendjes gjyqësore mbi kohën e vuajtjes së dënimit, çdo dokument tjetër që vërteton të qenët në punë dhe vërtetim mbi faktin e dënimit për motive politike dhe kohën e vuajtjes së tij.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE

Modelari nr.________

**SKEDË INFORMATIVE**
**MBI DOKUMENTACIONIN PËR PENSION FAMILJAR**

*Kushtet për të përfituar një pension familjar, sipas sipas nenit 40, të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në RSH", të ndryshuar, janë:*

1. *Mosha;*
2. *Periudha e sigurimit.*

*Ndërsa dokumentacioni i detyrueshëm për të përfituar pension familjar, është si më poshtë:*

| Nr. | EMËRTIMI I DOKUMENTACIONIT TË DETYRUESHËM | INSTITUCIONI QË LËSHON DOKUMENTIN |
|---|---|---|
| 1. | Fotokopje e Kartës së identitetit; | Vetë personi |
| 2. | Certifikatë vdekjeje (të jetë shënuar shkaku i vdekjes); | Zyra e Gjendjes Civile |
| 3. | Certifikatë familjare; | Zyra e Gjendjes Civile |
| 4. | Certifikatë lindjeje personale të fëmijëve përfitues; | Zyra e Gjendjes Civile |
| 5. | Certifikatë martese e të ndjerës (e detyrueshme vetëm për femrat) | Zyra e Gjendjes Civile |
| 6. | Librezë pune e të ndjerit/të ndjerës; | Qendra e Punës |
| 7. | Librezë kontributesh e të ndjerit/të ndjerës; | Qendra e Punës |
| 8. | Vërtetim për periudhën e Shërbimit të Detyrueshëm Ushtarak të të ndjerit. | Qendra e Personel Rekrutimit |

| | ***Dokumentacioni shtesë në rastet e mungesës së Librezës së punës dhe asaj të Kontributeve të të ndjerit:*** | |
|---|---|---|
| 1. | Deklaratë për vitet e punës; | Vetë personi |
| 2. | Vërtetim nga Qendra e punës për periudhat e punës; | Qendra e Punës |
| 3. | Vërtetim page, sipas së cilës është derdhur kontribut që nga viti 1994 deri në momentin e lënies së punës; | Qendra e Punës |
| 4. | Vërtetim i pagesës së papunësisë (asistencë); | Zyra e Punës |
| 5. | Vendim gjykate për njohje vjetërsie në punë; | Gjykata |
| 6. | Mandat-pagesat për derdhjen e kontributeve; | Vetë personi |
| 7. | Vërtetim për Pagesën kalimtare (si ushtarak). | Qendra e Punës |

| | ***Dokumentat shtesë në rastet kur i ndjeri ishte ish - i dënuar politik:*** | |
|---|---|---|
| 1. | Vërtetim për faktin e dënimit për motive politike dhe kohën e vuajtjes së tij; | Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve |
| 2. | Dëshmi penaliteti – vërtetim i gjendjes gjyqësore. | Zyra e Gjendjes Gjyqësore |

| | ***Dokumentacioni shtesë në rastet kur të ndjerit i ndryshojnë gjeneralitetet:*** | |
|---|---|---|
| 1. | Vërtetim nga Njësia Administrative/Bashkia për ndryshimin e gjeneralitetit; | Zyra e Gjendjes Civile |
| 2. | Vërtetim nga qendra e fundit e punës për gjeneralitetin. | Qendra e Punës |

| | ***Dokumentacioni shtesë në rastet kur i ndjeri/e ndjera ka punuar si kuadër në ish-kooperativë bujqësore:*** | |
|---|---|---|
| 1. | Vendimi i emërimit në punë, si kuadër; | Arkiva e Shtetit |
| 2. | Diploma e shkollës së mesme/lartë. | Drejtoria Arsimore/Shkolla e Lartë |

| | ***Dokumentacioni për përfitimin e pensionit familjar nga bashkëshortja/bashkëshorti:*** | |
|---|---|---|
| 1. | Vërtetim nga Njësia Administrative/Bashkia që i ndjeri ka bashkëjetuar me përfituesin | Bashkia/Komuna |
| 2. | Vërtetim nga dega e tatim-taksave për bashkëshortin/bashkëshorten; | Drejtoria Rajonale e Tatim - Taksave |
| 3. | Vërtetim si kërkues pune. | Shërbimi Kombëtar i Punësimit |

| | ***Dokumentacioni shtesë për përfitimin e pensionit familjar nga fëmijët:*** | |
|---|---|---|
| 1. | Vërtetim nga shkolla kur fëmija është mbi 18 – 25 vjet; | Drejtoria Arsimore/Shkolla e Lartë |
| 2. | Vërtetim nga dega e tatim-taksave për pjestarët që janë në ngarkim; | Drejtoria Rajonale e Tatim - Taksave |
| 3. | Vërtetim si kërkues pune. | Shërbimi Kombëtar i Punësimit |

| | ***Dokumentacioni shtesë për kompensimin e energjisë elektrike:*** | |
|---|---|---|
| 1. | Vërtetim për pagesën e energjisë elektrike; | OSSH |
| 2. | Deklaratë për kompensimin e energjisë. | Vetë personi, sipas formatit të ALSSH-së |

| | ***Për të përfituar një pension familjar suplementar shtetëror, konform neneve 12, 13, të Ligjit nr. 8097, datë 21.03.1996, i ndryshuar, duhet paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm:*** | |
|---|---|---|
| 1. | Fotokopje e Kartës së Identitetit; | Vetë personi |
| 2. | Certifikatë familjare; | Zyra e Gjendjes Civile |
| 3. | Vërtetim i vjetërsisë në shërbim/detyrë/funksion; | Qendra e Punës |
| 4. | Vërtetim i pagës referuese të detyrës/funksionit; | Qendra e Punës |
| 5. | Vërtetim e gjendjes gjyqësore; | Zyra e Gjendjes Gjyqësore |

| | ***Dokumenta shtesë për pension familjar suplementar si ish-ushtarak, konform neneve 19, 21, të Ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009 i ndryshuar:*** | |
|---|---|---|
| 1. | Fotokopje e Kartës së Identitetit; | Vetë personi |
| 2. | Certifikatë familjare; | Zyra e Gjendjes Civile |

### KUSH PËRFITON

1. E veja që mban një fëmijë deri në 8 vjeç; nuk është e aftë të punojë dhe që ka mbushur 55 vjeç.
2. Burri i ve, që mban një fëmijë deri në 8 vjeç; nuk është i aftë të punojë, ka mbushur moshën 60 vjeç.
3. Jetimët e moshës 18-25 vjeç që studiojnë apo janë të paaftë për punë.
4. Prindërit, kur kanë arritur moshën 65 vjeç ose janë të paaftë për punë.
5. Nipërit e mbesat, kur janë në ngarkim të atij që vdiq dhe bënin pjesë në të njëjtën familje me të.

### DOKUMENTET

Të gjithë ata individë që do të aplikojnë për pension familjar, duhet të dorëzojnë edhe dokumentet që vërtetojnë: moshën dhe identitetin, periudhat e sigurimit dhe llojin e punës, të qenët në ngarkim të të ndierit, si dhe vërtetimin e vazhdimit të shkollës për jetimët që kanë mbushur moshën ligjore për t'u punësuar.

**NJOFTIM SHITJE ME ANKAND**

Ne date 11.10.2017 ne oren 16.00 ne zyren e permbaruesit gjyqesor privat **Irisa Tereziu PF** me adrese ne "Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhe, Njesia Tregtare nr.10, Tirane", zhvillohet ankandi per shitjen e pasurise se paluajtshme te llojit "Njesi" me siperfaqe totale 87.2 $m^2$ , numer pasurie 15/231-N1, vol.2014-2016, ne zonen kadastrale 8551, me adrese Kavaje.Cmimi ne ankand te pare eshte ne vleren 8,329,553.6 (tete milion e treqind e njezet e nente mije e peseqind e pesedhjte e tre pike gjashte) lekë.

I vranë djalin e nipin, kryefamiljari apel shtetit: Të zbardhen ngjarjet në Vlorë, se rrezikojmë me jetë

# "Nuk kemi pasur qëllim hakmarrjen ndaj Llanajve"

## *Bilbil Rakipi: S'kam lidhje me atentatin në rrugën "Transballkanike"*

Enrik Mehmeti

**VLORË**

Pak ditë pas ngjarjes së rëndë të ndodhur në rrugën "Transballkanike" të qytetit të Vlorës ku mbeti i plagosur 39-vjeçari Ferdinand Llanaj, djali i tij 8-vjeçar B.Llanaj si dhe miku i tij, Dritan Begaj, ka reaguar babai i një prej viktimave të masakrës së Çoles të ndodhur në vitin 2015. Bëhet fjalë për Bilbil Rakipin, i ati i Haki Rakipit. Në një letër publike drejtuar krerëve të institucioneve në vendin tonë, ai kërkon drejtësi për të gjitha ngjarjet e pazbardhura në qytetin bregdetar, ndërsa thotë se familja e tij nuk ka pasur asnjëherë si qëllim hakmarrjen. Reagimi i Bilbil Rakipit ka marrë shkas nga fakti se pas atentatit të së dielës, policia e Vlorës deklaroi se pista kryesore ku po hetohet është ajo e hakmarrjes, por në dy drejtime të ndryshme. E para është ajo e konfliktit të masakrës se Çoles, ku vëllai i Ferdinand Llanajt, Aleksandri së bashku me dy miqtë e tij vranë të rinjtë: Akil Hasanaj, Ardi Velaj dhe Albi Limaj. E lidhur me këtë histori (sipas burimeve të policisë) është edhe vrasja e biznesmenit Erven Hyseni në Sheshin e Flamurit në Vlorë, ku mbeti i vdekur aksidentalisht edhe drejtori i OSHEE-së në Vlorë, Roland Saliu. Ndërkaq, në letrën drejtuar Presidentit të Republikës, Ilir Meta; kryeministrit Edi Rama; ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj; kryeprokurorit Adriatik Llalla si dhe drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Haki Çako, Bilbil Rakipi citon se, "me gjithë humbjen e djalit dhe nipit tonë, ne si familje jemi munduar të vazhdojmë jetën e përditshme, duke mos pasur synim hakmarrjen. Qëndrimi i prokurorisë dhe Policisë së Shtetit për problemin madhor që familjet kanë, duke abuzuar me heshtjen e tyre, duke u lënë hapësirë mediave për keqinformim ose mosinformim, i vë familjet në pozicion të vështirë dhe me rrezik për jetën".

**LETRA**

"Jam njëri nga prindërit e viktimave të masakrës së 7 prillit të ndodhur pranë tregut të Çoles në qytetin e Vlorës, pikërisht Bilbil Haki Rakipi, i ati i të ndjerit Haki Bilbil Rakipi. U detyrova të dal në shtyp dhe të shpreh shqetësimin tim familjar në lidhje me artikujt e botuar në media si dhe komente që bëjnë stacionet televizive shqiptare në lidhje me plagosjen e 3 qytetarëve në rrugën 'Transballkanike' në qytetin e Vlorës. Sipas pistave që ka ngritur policia, edhe media thekson se kjo ngjarje ka ndodhur si pasojë e dy ngjarjeve që kanë lidhje direkt me familjen time, ajo e masakrës së Çoles më 7 prill 2015 ku humbi jetën djali im, si dhe vrasja më 24 maj të këtij viti në oborrin e hotel 'Vlora', që edhe i ndjeri Erven Hyseni, njëri nga viktimat është djali i motrës sime, pra direkt nipi im. Dua të sqaroj opinionin publik si dhe institucionet kompetente se:

Problemin e vrasjes së djalit tim e kam ndjekur në çdo shkallë të gjyqësorit që ka Republika e Shqipërisë, me shumë padrejtësi, dhe sot vrasësi i djalit tim, Aleksandër Baftjar Llanaj qëndron i dënuar me 35 vjet burgim, ndërkohë në të gjitha dokumentet që ka brenda dosja hetimore del qartë që familjarët e tij nuk e kanë dashur atë që pjesëtari i familjes së tyre ka kryer. Shumë e vërtetë është që ne si palë e dëmtuar kemi kërkuar zbatimin maksimal të ligjit, ndërsa pjesëtarët e familjeve të vrasësve lehtësimin e veprës kriminale, dënimin minimal të tyre. Pavarësisht tensioneve të krijuara në seancat gjyqësore, ne si familje e viktimave kemi kërkuar drejtësi vetëm nëpërmjet shkallëve të gjyqësorit dhe denoncimeve në media. Familja ime është thirrur disa herë për t'u pyetur rreth të tria ngjarjeve në kohën e ndodhjes së tyre dhe gjithmonë kemi treguar pozicionin tonë familjar. Kjo nuk do të thotë që sa herë të kenë probleme dhe halle familjet e atyre që na kanë vrarë, të kontrollohemi dhe të merremi në pyetje ne që jemi viktimat. Përsa I përket vrasjes së nipit tim, të ndjerit Erven Hyseni, megjithëse kanë kaluar rreth 5 muaj, me gjithë hetimet, deklaratat në shtyp edhe nga gazetarë investigativë, se për këtë vrasje provat ishin plotësisht të mjaftueshme, shohim që nga Prokuroria e rrethit të Vlorës si dhe nga Drejtoria e Policisë Vlorë ka vetëm heshtje. Familja jonë dhe opinioni publik është jashtë çdo informacioni. Për këtë ngjarje të rëndë të ndodhur në mes të qytetit të Vlorës, institucionet e lartpërmendura duhet të sqarojnë opinionin publik dhe familjet e viktimave.


Vendi ku ndodhi masakra e Çoles

**APELI**

Në letrën drejtuar Presidentit të Republikës, Ilir Meta; kryeministrit Edi Rama; ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj, kryeprokurorit Adriatik Llalla si dhe drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Haki Çako, Bilbil Rakipi citon se, "me gjithë humbjen e djalit dhe nipit tonë, ne si familje jemi munduar të vazhdojmë jetën e përditshme, duke mos pasur synim hakmarrjen".


HESHTJA E PROKURORIS DHE POLICIS LE VEND PER SPEKULLIME DUKE THELLUAR KONFLIKTIN KRIMINAL NE VLORE

Jam njeri nga prinderit e viktimave te masakres se 7 prillit te ndodhur prane tregut te coles ne qytetin e Vlores, pikerisht jam Bilbil Haki Rakipi I jati I te ndjerit Haki Bilibil Rakipi .

U detyrova tedal ne shtyp dhe te shpreh shqetesimin tim fmiljar ne lidhje me artikujt e botuar nga media si dhe komente qe bejne stacionet televisive shqiptare ne lidhje me plagosjen e 3 qytetareve ne rrugen Transballkanike ne qytetin e Vlores.

Sipas pistave qe ka ngritur policia edhe media thekson se kjo ngjarje ka ndodhur si pasoje e dy ngjarjeve qe kane lidhje direct me familjen time, ajo e masakres se coles me 7 prill 2015 ku humbi jete ndjali im, si dhe vrasja me 24 maj te ketij viti ne oborrin e hotel Vlora qe edhe I ndjeri Erven Hyseni njeri nga viktimat eshte djali I motres sime, pra direct nipi im.

Dua te sqaroj opinionin publik si dhe te insitucionet kompetente se:

Problemin e vrasjes se djalit tim e kam ndjeur ne cdo shkalle te gjyqesorit qe ka Republika e Shqiperis, me shume padrejtesi, dhe sot vrasesi i djalit tim Aleksander Baftjar Llanaj qendron i denuar me 35 vjet burgim, nderkohe ne te gjitha dokumentat qe ka brenda dosja hetimore del qarte qe familjaret e tij nuk e kane dashur ate qe pjestari i familjes se tyre ka kryer.

Shume e vertete eshte qe ne si pale e demtuar kemi kerkuar zbatimin maksimal te ligjit ndersa pjestaret e familjeve te vrasesve lehtesimin e vepres kriminale, denimin minimal te tyre.

Pavaresisht tensioneve te krijuara nga seancat gjyqesore ne si familje e viktimave kemi kerkuar drejtesi vetem nepermjet shkalleve te gjyqesorit dhe denoncimeve ne media.

Familja ime eshte thirrur disa here per tu pyetur rreth te treja ngjarjeve ne kohen e ndodhjes se tyre dhe gjithmon kemi treguar pozicionin tone familjar. Kjo nuk do te thote qe sa here te kene probleme dhe halle familjet e atyre qe na kane vrare te kontrollohemi dhe te merremi ne pyetje ne qe jemi viktimat.

Persa i perket vrasjes se nipit tim te ndjerit Erven Hyseni megjithese kane kaluar rreth 5 muaj, me gjithe hetimet, deklaratat ne shtyp edhe nga gazetare investigativ, se per kete vrasje provat ishin plotesisht te mjaftueshme, shohim qe nga Prokuroria e rrethit te Vlores si edhe nga Drejtoria e Policis Vlore ka vetem heshtje. Familja jone dhe opinioni publik eshte jashte cdo informazioni. Per kete ngjarje te rende te ndodhur ne mes te qytetit te Vlores, insitucionet e lartpermendura duhet te sqarojne opinionin publik dhe familjet e viktimave.

Me gjithe dhimbjen nga humbja e djalit dhe nipit tone,ne si familje jemi munduar te vazhdojme jeten e perditshme, duke mos pasur synin hakmmarrjen. Qendrimi i Prokuroris dhe i Policis se shtetit per problemin madhor qe familjet kane, duke abuzuar me heshtjen e tyre, duke lene hapsire mediave per keqinformim ose mosinformim, i ve familjet ne pozicion te veshtire dhe me rrezik per

...i bej thirrje Presidentit te Repulikes Z.Ilir Meta, Kryeministrit Z. Edi Rama, ...endshme Z.Fatmir Xhafa, prokurorit te pergjithshem Z.Adriatik Llalla si

Faksimile e letrës së Bilbil Rakipit

**NIPI**

"Përsa i përket vrasjes së nipit tim, të ndjerit Erven Hyseni, megjithëse kanë kaluar rreth 5 muaj, me gjithë hetimet, deklaratat në shtyp edhe nga gazetarë investigativë se për këtë vrasje provat ishin plotësisht të mjaftueshme, shohim që nga Prokuroria e rrethit të Vlorës si dhe nga Drejtoria e Policisë Vlorë ka vetëm heshtje. Familja jonë dhe opinioni publik është jashtë çdo informacioni. Për këtë ngjarje të rëndë të ndodhur në mes të qytetit të Vlorës, institucionet e lartpërmendura duhet të sqarojnë opinionin publik dhe familjet e viktimave.

---

## 4 prej tyre, inspektorë të EM dhe Mjedisit

# Prerja e paligjshme e pyjeve, procedohen 8 persona në Manëz

**DURRËS** - Policia e Durrësit vijon operacionin "Roja i Gjelbër" për të parandaluar prerjen e paligjshme të pyjeve. Në kuadër të këtij operacioni janë proceduar në Manëz 8 persona, 4 prej të cilëve me detyrë inspektorë të Emergjencave Civile dhe Shërbimit të Mjedisit Pyjor. Gjithashtu, janë sekuestruar 17 metra sterë dhe 4 metra kub dru. Burime nga blutë pohuan se ka filluar procedimi penal për shtetasit: S.D. 55 vjeç, banues në Ishëm, me detyrë inspektor i Emergjencave Civile; R.S. 52 vjeç, banues në Ishëm, me detyrë inspektor i Emergjencave Civile; E.C. 28 vjeç, banues në Durrës, me detyrë inspektor i Shërbimit të Mjedisit Pyjor; A.C. 30 vjeç, banues në Ishëm, me detyrë inspektor i Shërbimit të Mjedisit Pyjor, pasi akuzohen për "shpërdorim të detyrës". Gjithashtu, janë shpallur në kërkim dhe po punohet për kapjen e shtetasve: Z.B. 25 vjeç, banues në Ishëm dhe G.B. 32 vjeç, banues po në Ishëm. Mësohet se më datë 03.10.2017, gjatë kontrollit të ushtruar në fshatin Rrotull, Ishëm është konstatuar prerje e paligjshme e pyjeve nga dy shtetasit e shpallur në kërkim. Në lidhje me këtë ngjarjeje ka nisur procedimi penal në ngarkim të shtetasve: Gj.Ç. 76 vjeç, banues në Manëz dhe B.Sh. 42 vjeç, banues në Hamallaj, të cilët akuzohen për "prerje të paligjshme të pyjeve".



---

**PUKË**

# U dezinfektuan ambientet e shkollës, helmohen 10 nxënës

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur paraditen e djeshme në njësinë administrative Gjegjan të Bashkisë së Pukës. 10 nxënës të shkollës 9-vjeçare të këtij fshati janë helmuar gjatë orëve të mësimit, ndërsa mësohet se shkak është bërë dezinfektimi i klasave. Nëpërmjet një njoftimi, policia bëri me dije se "janë dezinfektuar ambientet e shkollës më datë 03.10.2017 në orën 14:00 nga Shërbimi i Shëndetit Publik me klor, në kuadër të dezinfektimit të Shkollave. Sot (dje) më datë 04.10.2017 pasi kanë filluar procesin mësimor, kanë shfaqur probleme shëndetësore disa nxënës, të cilët kanë shkuar për ndihmë mjekësore në Qendrat Shëndetësore më të afërta. Momentalisht pohohet se janë 10 nxënës, nga të cilët kanë shkuar në qendrën shëndetësore në Rrëshen 3 fëmijë; në Qendrën Shëndetësore në Pukë 3 fëmijë dhe në Qendrën Shëndetësore në Gjegjan 4 fëmijë, ku nuk paraqesin probleme për jetën. Nga ana Policisë po kryhen veprimet me grup hetimor për sqarimin e rrethanave të plota të kësaj ngjarjeje".

**Policia: Dyshime për konflikt mes të rinjsh**

## Plagoset me armë një 25-vjeçar në Durrës, shpallet në kërkim autori i krimit

Një plagosje me armë zjarri ka ndodhur mbrëmjen e djeshme qytetin e Durrësit. Ngjarja ka ndodhur në lagjen numër 18 të qytetit, ndërsa burime pranë policisë bënë me dije se i lënduar ka mbetur shtetasi M.P., 23 vjeç. Menjëherë pas ngjarjes së rëndë, ai u dërgua me urgjencë në spital për të marrë ndihmën e nevojshme dhe fatmirësisht ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Mësohet se i riu ka marrë plagë në këmbë. Plagosja ka ndodhur në një zonë të populluar me njerëz, të cilët sapo dëgjuan të shtënat, lajmëruan menjëherë policinë. Uniformat blu mbërritën në vendin e ngjarjes ku nisën punën për zbardhjen e plotë të rrethanave, identifikimin dhe vënien në pranga të autorit të krimit. Për këtë, policia ka shoqëruar për të marrë në pyetje disa kalimtarë të zonës për të dëshmuar në lidhje me atë se çfarë panë, nëse e kanë njohur ose jo autorin, ndërsa pritet të merret në pyetje edhe 25-vjeçari i plagosur. Burimet thanë se dëshmia e të riut do të çojë në identifikimin e autorëve dhe në zbardhjen e ngjarjes. Pas një pune të mirorganizuar, blutë e Durrësit shpallën në kërkim si autor të dyshuar 31-vjeçarin me iniciale Gj.Sh., ndërsa dyshohet se mes tyre mund të ketë pasur ndonjë konflikt. **kl.ha.**



Vendi ku ndodhi ngjarja

Krimet që rëndojnë mbi të riun; nga sulmi me antitank ndaj Çapjave, te masakra e 3 shkurtit në Elbasan

# Goditi me "Audi" policinë, kapet anëtari i bandës "Çela"

## *Pas përplasjes, Ena Bekteshi fshihej tek shtëpia e kunatit në Cërrik*

ELBASAN

Dy javë pas goditjes së makinës së zëvendësdrejtorit të policisë së Elbasanit nga një makinë tip "Audi" e blinduar, ka përfunduar në pranga Enea Bekteshi, i cili dyshohet se është anëtar i bandës "Çela" në këtë qytet. 31-vjeçari u kap nga skuadra e operacioneve speciale në Cërrik, pasi dyshohet se ishte shofer i automjetit që goditi makinën e bluve mbrëmjen e 18 shtatorit të këtij viti. Arrestimi i të "fortit" të Elbasanit pasoi vetëm tri ditë pas deklaratave të forta të ambasadorit amerikan, Donald Lu se vendin tonë e drejtojnë 4 klane dhe 20 familje mafioze, si dhe një orë pas paralajmërimit të kryeministrit Rama nga Fieri se "do të ketë rezultate konkrete për sulmin ndaj policisë pak ditë më parë në Elbasan". Ndërkohë, burime nga policia e Elbasanit mbrëmë bënë me dije se Bekteshi ishte fshehur në banesën e kunatit të tij, Aleks Pupuleku në Cërrik që pas momentit të incidentit me policinë e Elbasanit. Pas arrestimit, gjatë kontrolleve të ushtruara në banesë, iu gjet dhe iu sekuestrua në cilësinë e provës materiale edhe një sasi lënde narkotike (kanabis). Gjithashtu, blutë kanë prangosur dhe 40-vjeçarin Pupuleku.

**SULMI NDAJ POLICISË**

Ngjarja e rëndë ndodhi mesnatën e 18 shtatorit në qytetin e Elbasanit, kur një automjet i blinduar tip "Audi A8" goditi nga pas makinën e patrullës së policisë me targa MB 002 AA, që po shoqëronte për verifikim në komisariat një "Range Rover" me vlerë 100 mijë euro. Pas sulmit ndaj bluve në lagjen "Dyli Haxhire", në operacion u angazhuan dhe Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë (FNSH) dhe RENEA, pasi situata doli nga kontrolli. Më pas autorët që lëviznin me makinën e blinduar janë futur në ambientet e tregut agro-ushqimor, ku dhe kanë humbur gjurmët. Gjatë kontrolleve të ushtruara u bë i mundur arrestimi i shtetasve: Ledio Zabeli 26 vjeç dhe Kelmend Xhaferri 35-vjeç, të dy banues në Elbasan. Ky i fundit drejtonte në automjetin, i cili u ndalua për kontroll dhe verifikim nga policia, ndërsa Zabeli ishte pasagjer. Gjatë kontrollit në banesat e tyre, policia gjeti një armë sportive, pushkë pa leje si dhe një sasie lëndë narkotike. Gjithashtu, u vu në pranga edhe roja i tregut agro-ushqimor, Valmir Dedja, i cili pengoi oficerët e policisë për të ushtruar kontroll. Në lidhje me këtë ngjarje, policia deklaroi se ka identifikuar dhe shpallur në kërkim drejtuesin e mjetit tip "Audi" me targa AA 795 EP, shtetasin P.C..

**KUSH ËSHTË ENEA BEKTESHI**

Emri i Enea Bekteshit që u arrestua dje në Cërrik si një nga personat që ishte brenda makinës së blinduar "Audi" figuron në shkresën që Prokuroria i kërkonte policisë ta vinte në përgjim si pjesë e një bande të rrezikshme kriminale në qytetin e Elbasanit. Ai dyshohet se është pjesë e bandës "Çela", që disa muaj më parë, më 6 gusht 2017 qëlloi antitank biznesin e fisit "Çapja", hotel "Universin", me të cilët kanë rivalitet në fushën e krimit. Po ashtu, Enea Bekteshi dyshohet të jetë pjesëtar në masakrën e 3 shkurtit në Elbasan, tek lokali ku qëndronin pjesëtarët e familjes Çapja ku u vranë Agron Çapja, Eno Bedalli dhe Ardit Sinakolli si dhe u plagosën 8 persona të tjerë. Prej ditësh forcat speciale janë përqendruar në Elbasan, në disa aksione të gjëra, pasi ka ngritur zërin edhe vetë ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj, por u deshën fjalët e forta të ambasadorit Lu, që të shiheshin konkretisht rezultatet e aksioneve policore.



I arrestuari Ena Bekteshi





## Arrestimi i anëtarit të bandës së Elbasanit, ja kush e refuzoi përgjimin e tij

**ELBASAN** - Mësohen detaje të reja nga arrestimi i Enea Bekteshit, personit që goditi makinën e zëvendësdrejtorit të Policisë së Elbasanit, Gjergj Oshafi. Burime për "Tpz.al" konfirmuan se për Enea Bekteshin dhe Sokol Sanxhaktarin (dhëndrin e kryebashkiakut Qazim Sejdini) ishte kërkuar leja nga prokurori Elbasanit, Fatmir Lushi, për të përgjuar numrat e telefonave të tyre, si dhe të përgjoheshin me pamje fotografike, filmike dhe video, por drejtuesi i lartë, Idajet Faskaj e kishte refuzuar, siç shihet edhe në dokumentet ekskluzive të siguruara nga "Tpz.al". Në listën e të përgjuarve ishte dhe Kelment Xhaferi, po nga Elbasani. Por, kur Lushi kërkoi autorizimin e përgjimit nga një instancë më e lartë, erdhi refuzimi. Me shkresën, nr.939/1, datë 23.08.2017, drejtori Idajet Faskaj jep arsyet se përse nuk mund të realizohej përgjimi. "Në kuadrin e veprimeve procedurale lidhur me procedimin penal nr. 1295, viti 2017, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, për veprat penale të vrasjes në rrethana të cilësuar e mbetur në tentativë, prodhimit dhe mbajtjes pa lejë të armëve dhe municioneve luftarake dhe shkatërrimit të pronës me dashje, të parashikuar nga nenet 79/dh, 22,278 dhe 150 të të Kodit Penal, autorizimit të prokurorit, Z.Fatmir Lushi të datës 10.08.2017 'Për përgjimin në vendet publike', ju informojmë se nga ana e Sektorit të Forcës së Posaçme, nisur nga dinamika e madhe me shërbime në funksion të procedimeve penale në ndjekje dhe numrit të limituar të ndihmës së specialistëve si pasojë e ndjekjes së grafikut të pushimeve vjetore, është e pamundur kryerja e veprimeve të vëzhgimit të fshehtë të personave dhe mjediseve në këtë periudhë kohore. Duke ju falënderuar për mirëkuptimin! Drejtori, drejtues i lartë, Idajet Faskaj".



Nr 939/1 Prot

Afati i ruajtjes ... vjet
Kopje nr. 1
Tiranë, më 23.08.2017

Lënda: Dërgojmë informacion

PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
ELBASAN
PROKURORIT Z.FATMIR LUSHI

...ë kuadrin e veprimeve procedurale lidhur me procedimin penal nr.1295 viti 2017 të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, për veprat penale të Vrasjes në rrethana të cilësuar e mbetur në tentativë, prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armeve e municioneve luftarake dhe shkatërrimit të ... me dashje, të parashikuar nga nenet .../dh, 22.278 dhe 150 të K.Penal, autorizimit të Prokurorit Z.Fatmir Lushi të datës 10.08.2017 - Për përgjimin në vende publike - ju informojme se nga ana e Sektorit të Forcës Posaçme, nisur nga dinamika ... me sherbime ne funksion të procedimeve penale në ndjekje dhe numrit të ... të ndihmës specialisteve si pasoje e ndjekjes se ...



### Qytetari dixhital, Berishës: Sejdinit i kanë dërguar arkivol në shtëpi

Në ngjarjet e ndodhura gjatë ditëve të fundit në Elbasan është përfshirë edhe emri i kryetarit të bashkisë së këtij qyteti, Qazim Sejdini. Qytetarët theksojnë se personi i arrestuar dje është thjesht një ushtar dhe se autorët e vërtetë mbrohen nga Rama dhe Qazim Sejdini. Ndërsa theksojnë se në Elbasan flitet se banda rivale e ka kërcënuar me jetë Sejdinin, duke i dërguar një arkivol tek shtëpia. Denoncimi i qytetarit është bërë publik nga ish-kryeministri Sali Berisha. Ja çfarë shkruan në "Facebook" ish-kryeministri: "Në Elbasan klanet në thikë e në pikë! Qyteti gumëzhinë se Don Lalës klani tjetër mafioz i ka dërguar arkivol në shtëpi! Lexoni mesazhin e qytetarit dixhital! sb

'Doktor mirëmbrëma. Po lexoj nëpër media sikur policia në Elbasan ka arrestuar autorin e ngjarjes së 18 shtatorit, sikur u kap autori. Ky është një lajm sa për të bërë bujë, sepse autorët e vërtetë nuk janë kapur, ata mbrohen nga Edi Rama dhe Qazim Sejdini. Këta që janë arrestuar janë thjesht ushtarë. Sa për Qazim Sejdinin, mikun më të ngushtë të Edi Ramës, sot në qytet po qarkullon një lajm sikur i kanë dërguar arkivol në shpi, në shenjë hakmarrjeje për ato që ai ka bërë. Nuk dihet sa i vërtetë është ky lajm, por sot i gjithë Elbasani po flet për këtë ngjarje. Të gjithë e dinë në Elbasan që Qazim Sejdini ka shumëfishuar rojet dhe badiguardët'".

REPORTAZH

# Nga Selenica në Tamarë, për turizmin gjithëvjetor mes zanave

*Shkëmbim eksperiencash mes Bashkisë së Malësisë së Madhe dhe asaj të Selenicës*

Bashkia e Malësisë së Madhe kufizohet në veri me Malin e Zi dhe në jug me Bashkinë e Shkodrës. Qendra e Bashkisë së Malësisë së Madhe është qyteti i Koplikut. Malësia e Madhe ka bukuri të shumta natyrore, ku përmendim Liqenin e Shkodrës dhe pikat turistike malore të Vermoshit, Razmës dhe Bogës. Blegtoria, bujqësia dhe turizmi janë burimet kryesore ekonomike për banorët e kësaj zone. Ndërsa dy të parat kanë një traditë zhvillimi qindravjeçare, i treti, turizmi, ka marrë hov në këtë dy dekadat e fundit falë investimeve që janë kryer në këtë hapësirë si nga pushteti qendror dhe ai vendor, përmes rrugëve automobilistike, ashtu edhe nga sipërmarrjet private me ngritjen e strukturave pritëse për turistët vendas dhe të huaj. Instituti i Librit dhe i Promocionit, në datat 8-15 shtator 2017 ndërmori realizimin e një sërë aktivitetesh, të cilat kishin si qëllim kryesor ravijëzimin e një strategjie informuese mbi mundësitë e zhvillimit të një turizmi shumëformësh e gjithëvjetor në fshatrat përgjatë Lumit të Vlorës. Për këtë, një grup administratorësh, përfaqësues të pushtetit vendor dhe biznesmenë nga Bashkia e Selenicës, së bashku me ILP-në, u nisën në një udhëtim 4-ditor për në Bashkinë e Malësisë së Madhe. Udhëtimi në këtë bashki nisi me një takim miqësor në qytetin e Koplikut, me kryetarin e saj Tonin Arapi dhe funksionarë të tjerë të bashkisë.

**HIKING DHE TREKKING**

Pas një dreke tradicionale në Koplik vazhduam drejt Lëpushës, përmes qafës së Bërdalecit në zonën e Kelmendit, ku rruga e shtruar dukej si një pistë e madhe për kampionatet e Formula Uno-s . Por jo vetëm kaq, hapësirat e blerta rreth saj e plot shtigje, mund të shërbenin mjaft mirë për hiking dhe trekking. Njëra nga ndalesat e radhës ishte fshati i Tamarës, një fshat që na mbeti në zemër, i ndërtuar rreth një sheshi me lokale të vogla e stola për pushuesit, mbi një ura urat e lumit Cen, me shtëpiza uniforme, me çati të kuqërremta, nën këmbët e maleve madhështore. Tamara ngjante me një qytezë përtej kohës dhe vendit, si ato qytezat që gjejmë në perëndim të Europës dhe na lënë pa frymë, pasi kanë shumë për t'u ofruar shqisave të njeriut, si aromë, shije, ndjesi, emocione dhe përjetime. Pasditja na zuri në Lëpushë, në një bujtinë alpine ku u pritëm me kafe e raki boronice. Grupi nga Selenica performoi disa këngë tradicionale të polifonisë labe dhe për t'i dhënë një zë edhe më origjinal vizitës tonë, polifoninë e shoqëruam me çiftelinë malësore. Bujtinat apo hanet (12 të tilla



në këtë zonë) janë një nga risitë që turizmi në veri të Shqipërisë i ka dhënë një dimension të ri mikpritjes së popullit shqiptar ndër shekuj. Ashtu siç tregon Luigj Cekaj, fillimisht 10 vjet më parë, ai kishte një shtëpi dhe një mjedis të gjelbëruar si pronë të tij. Asokohe aty shkonin të huaj, të cilët kishin me vete çadra dhe çanta shpine si edhe një kureshtje të madhe për këto vise të virgjëra e të panjohura për ta. Luigji i ndihmonte duke u dhënë dyshekë për t'u shtrirë natën në çadrat e tyre, apo të bujtnin në mjediset bosh të shtëpisë së tij, duke u ofruar ushqim falas nga kuzhina e tij familjare. Kështu nisi kjo traditë e re, por me rrënjë tejet shekullore si te shumë familje të tjera në këtë bashki, e cila është prekur nga emigrimi masiv i rinisë së saj, kryesisht në SHBA, por vijon të jetë ende e gjallëruar falë mikpritjes dhe bujarisë. Numri i turistëve gjatë vitit të fundit ka qenë më i madh se 5000 persona, të cilët, përveç të tjerave, kanë marrë pjesë edhe në eventin "Logu i Bjeshkëve 2017", ku u zgjodh "Miss Malësia e Madhe". Të nesërmen, në Vermosh, u takuam me Vasel Lukë Mitajn. Ai së bashku me të shoqen na shërbyen kafe, raki, lëng kumbulle dhe djathë. Gjithashtu, na treguan se si turistë nga vende të ndryshme të Europës, si Çekia, Sllovakia, Bullgaria e Polonia ishin bujtës të rregullt të kësaj zone. Aty takuam edhe një grup motoristësh nga Çekia, të cilët kishin ardhur me motorët e tyre, në këto ditë të bukura shtatori, për të vizituar e parë nga afër bjeshkët tona. Pak minuta më tutje, me makinë u gjendëm në Kishën e Vermoshit në Majën e Marlules. Ditën tjetër mbërritëm përtej kufirit falës rrugës së shtruar, në më pak se 2 orë nga Kelmendi në Guci. Në mjediset e Bashkisë, u takuam me kryetaren, Anela Cekic, e cila ushtron funksionet e saj vendore. Me të biseduam mbi rrugën, si thelbi i gjithë këtij rrugëtimi, mbi faktin se si shtrimi i rrugëve kryesore lidhëse mes dy shteteve do të sjellë përmirësime të dukshme në zhvillimin e turizmit dhe të komunikimit mes banorëve fqinjë. Edhe atje emigrimi, shpërngulja masive e të rinjve, si pasojë e problemeve ekonomike ishte një dukuri e ngjashme me atë që vumë re në Malësinë e Madhe. Në ndërtesën e bashkisë gjendej edhe një muze me veshje tradicionale, divane, enë kuzhine, makinë shkrimi, radio e orendi të tjera të rëndësishme nga aspekti kulturor i vlerave që mbartin.

**NË VUTHAJ ME REXHEP QOSJEN**

Në Vuthaj të Gucisë patëm mundësinë të vizitonim shtëpinë e akademikut të madh, prof.Rexhep Qosja, të drekonim në një restorant tipik vendës ku kënduam këngë polifonike, shijuam gatime tradicionale dhe natyrën e bukur të bjeshkëve. Mbrëmja e fundit e kësaj vizite 4-ditore na gjeti në Razëm, aty ku breza të tërë të rinjsh e të rejash kanë kaluar të paktën një herë në jetën e tyre dhe do të kalojnë për të qëndruar në hotelet e zonës dhe për t'u argëtuar me resurset e shumta që ofron natyra bujare. Shpërndarja është një nga pikat e dobëta në zhvillimin e ekonomisë së zonës, pasi vërtet, nga njëra anë, fshatarët mbulojnë nevojat e hoteleve dhe të bujtinave, por nga ana tjetër, falë këtij sistemi të mbyllur këto prodhime shkojnë përtej këtij qarku vetëm në rrugë të tërthorta, falë blerjeve të vogla që mund të bëjë një turist, i cili i ka shijuar këto produkte.

Pas një dite pushimi, përfaqësues të ILP-së dhe një grup nga bashkia e Malësisë së Madhe u nisën drejt qytetit të Vlorës, për të organizuar në fshatin Kotë, pjesë e bashkisë së Selenicës, vijimësinë e këtyre aktiviteteve të mbështetura nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Në qendër të fshatit Kotë, aty ku gjendet i ngritur një lapidar përkujtimor i Luftës së Vlorës, më 1920, u improvizua një skenë e vogël ku folën përfaqësues nga ILP-ja, Bashkia e Malësisë së Madhe, bashkia Selenicë, komuna e Kotës, Agjencia për Zhvillimin e Turizmit dhe nga Shoqata e Restoranteve Turistike Shqiptare. Në këtë takim u fol, mes të tjerave, edhe mbi iniciativën e binjakëzimit mes dy bashkive të sipërpërmendura, si dy zona me shumë ngjashmëri në fusha të ndryshme, si: blegtoria, bujqësia dhe dëshira për të kultivuar traditat e për të zhvilluar më tej sipërmarrje të përbashkëta me qëllimin fitimin e përvojës dhe bashkëpunim nga njëra-tjetra. Më pas, të gjithë të pranishmit u drejtuan drejt çadrave të ngritura enkas aty, ku shijuan prodhime të gatuara nga amvisat e fshatit me shumë shije e përkushtim.

Në Vlorë u realizua takimi përmbyllës i këtyre aktiviteteve. Çështjet kryesore që u ngritën pas kësaj vizite disaditore në veri dhe në jug ishin informimi dhe sensibilizimi i banorëve në fshatrat përgjatë Lumit të Vlorës mbi rëndësinë e turizmit si burim zhvillimi i kësaj zone, realizimi i studimeve mbi përcaktimin e resurseve reale që kjo zonë ka për të ndërtuar pika turistike të rëndësishme e tërheqëse për vizitorët e saj, përthithja jo vetëm nga ana e qeverisë apo e pushtetit lokal e fondeve investuese për zhvillimin e turizmit, por edhe e sipërmarrësve të vegjël që mund të realizojnë projekte për të tërhequr investitorë vendës, si bankat, apo edhe të huaj, si projekte e fonde europiane që tashmë kanë në fokus investimet në zonën e jugut të Shqipërisë. E pranishme në këtë debat ishte edhe Madlina Puka, drejtore e Përgjithshme e Agjencisë për Zhvillimin Rajonal 4, e cila u shpreh se ishte e befasuar nga ky projekt, i cili ndryshe nga projekte të tjera ku bëhet shkëmbimi i përvojave të zonave shqiptare me zona të huaja është fokusuar mbi binjakëzimin e një zone të zhvilluar, si Bashkia e Malësisë së Madhe, me një zonë si ajo e Bashkisë së Selenicës, ku me ndërtimin e rrugës do të vijë edhe zhvillimi i turizmit falë punës së blegtorëve e bujqve të zotë të kësaj zone. Një ndër mësimet më të mira që morëm nga ky rrugëtim qenë fjalët e të zotit të bujtinës në Vermosh: "Realizimi i rrugës nuk duhet t'i gjejë të papërgatitur banorët, por ata duhet të fillojnë vetë nga puna për të ngritur strukturat mikpritëse, për të trajnuar stafet që do të merren me shërbimin dhe në këtë mënyrë, ardhja e turistëve, me rrugën e realizuar, nuk do t'i gjejë të papërgatitur".

This project is funded by the European Union

KOLEGJI UNIVERSITAR BEDER · ISD Powering new generations against extremism · Centre for Common Ground · Terre des hommes Për fëmijët në mbarë botën. tdh.ch

## CALL FOR PROPOSALS ANNOUNCEMENT

Terre des hommes (Tdh) in partnership with Institute for Strategic Dialogue (ISD), Center for Common Ground (CCG) and Beder University is implementing the project "Strengthening Civil Society to build youth resilience to Violent Extremism", funded by the European Union.
The initiative aims to contribute to ensuring the active participation of civil society in preventing/countering violent extremism through building youth resilience by empowering CSO's working with young people and communities. In this framework a Call for Proposal under the Sub-Granting Scheme is effective **29th September 2017-30th October 2017.**
The overall amount made available under this Call for Proposals is **EUR 201,000.**
Tsh Albania aims to award around 25 projects, which must fall between the following minimum and maximum amounts:

1st category: - **5,000 EURO** (up to 5 projects)
2nd category: **5001- 7,500 EURO** (up to 10 project)
3rd category: **7,501- 10,000 EURO** (up to 10 project)

The deadline for the submission of applications is **30 October 2017 at 17:00.**
The application package and related information must be found to the following links:
https://www.facebook.com/search/top/?q=terre%20des%20hommes%20albania
www.cildhub.org
A copy of the Guidelines and Application package can be additionally requested through sending an email at: info@tdhalbania.org

This project is funded by the European Union

KOLEGJI UNIVERSITAR BEDER · ISD Powering new generations against extremism · Centre for Common Ground · Terre des hommes Për fëmijët në mbarë botën. tdh.ch

## THIRRJE PËR PROJEKT PROPOZIME

Terre des hommes (Tdh) në partneritet me Institutin për Dialog Strategjik (ISD), Qendrën për Baza të Përbashkëta (CCG) dhe Universitetin Bedër, po zbaton projektin "**Fuqizimi i Shoqërisë Civile në Ngritjen e Reziliencës Rinore ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm**", financuar nga Bashkimi Evropian.
Kjo iniciativë synon të kontribuojë në pjesëmarrjen e shoqërisë civilë në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm nëpërmjet ngritjes së reziliencës rinore duke fuqizuar organizatat të cilat punojnë me të rinjtë dhe komunitetin. Në këtë kuadër, Terre des Hommes në Shqipëri, hap një Thirrje për Projekt Propozime nëpërmjet skemës së Sub-Grantimit. Kjo Thirrje për Projekt Propozime do të qëndrojë e hapur gjatë periudhës **29 Shtator - 30 Tetor 2017**.

Totali i shumës për t'u kontraktuar nën këtë Thirrje për Projekt Propozime është **201,000 EURO**

Tdh Albania synon të krontaktojë rreth 25 projekte, të cilat ndahen sipas kategorive të mëposhtme:
Kategoria e parë: - **5,000 EURO** (deri në 5 projekte)
Kategoria e dytë: **5001- 7,500 EURO** (deri në 10 projekte)
Kategoria e tretë: **7,501- 10,000 EURO** (deri në 10 projekte)

Afati për dorëzimin e projekt propozimeve është **30 Tetor 2017, ora 17:00.**

Dokumentat e aplikimit dhe informacionin më të detajuar për mënyrën e aplikimit mund të gjeni në adresat e mëposhtëme:
https://www.facebook.com/search/top/?qëterre%20des%20hommes%20albania
www.cildhub.org

Një kopje e udhëzimeve për Projekt Propozime dhe dokumentat e aplikimit mund të kërkohen edhe duke dërguar një e-mail në adresën: info@tdhalbania.org

EKSPOZITA


Lala Meredith-Vula, Mullarët, Vica, 11 nëntor 2016


Lala Meredith-Vula, Kujtesë Gjaku, Malishevë, 2 maj 1990


Shifting borders

# Lala Meredith-Vula
## Kujtesë gjaku nga atdheu

*"Urtësi sot e mot", artistja me ekspozitë personale, të kuruar nga Monika Szewczyk*

Fatmira Nikolli

Pajtimi i gjaqeve ka qenë për të një prej përvojave të paharrueshme në jetë. Kishte, sipas Lala Meredith-Vulës, një ndjenjë kolektive shprese - se në rrethana shtypëse, ne, së paku kemi njëri-tjetrin. Kishte njëherësh një farë përshtypjeje se po krijohej historia dhe se secili po merrte pjesë në një moment madhështor, "si të ishte, ma merr mendja, momenti kur Ismail Qemali para grumbullit të njerëzve e shpalli pavarësinë". Ka qenë për artisten moment vërtet frymëzues. Në një rrëfim në "Kosovo2.0", artistja me baba shqiptar e nënë angleze, kujton rininë e largët ku nisi dokumentimin në imazhe të pajtimit të gjaqeve disavjeçare, herë-herë shekullorë në Kosovë, kur ende ishte gjallë e i qe kushtuar këtij "pajtimi kombëtar" Andon Çeta. Atëkohë, e re dhe pothuaj "e huaj" sa i takon njohjes së traditave shqiptare, ajo e ndiqte çdo gjë me kureshtjen e një të sapoardhuri. "Procesi i pajtimit të gjaqeve, niste me identifikimin e hasmërive të llojllojshme brenda fshatit dhe pastaj grupi lokal i pajtimit shkonte dhe i vizitonte familjet e përfshira në përpjekje për t'i pajtuar gjaqet. Caktohej data dhe dy familjet takoheshin në ceremoninë publike të pajtimit. Në këto ceremoni kishte lexime, dhe aty merrnin pjesë Anton Çeta dhe profesorë e personalitete të tjera të respektuara. Pastaj një nga një, familjet e ndryshme dilnin përpara dhe përqafoheshin apo i shtrëngonin duart derisa të pranishmit duartrokisnin", - ka kujtuar ajo në "Kosovo2.0". Ato imazhe më vonë u bënë pjesë e projektit të saj Blood Memory (Kujtesë Gjaku).

Një tjetër projekt me të cilin ajo është shfaqur në disa ekspozita është ai i mullarëve të barit nëpër fshatra, "Haystacks". Për të, mullarët dukeshin si pikë e mrekullueshme qendrore e peizazhit. "Përfaqësonin aq shumë: bëhen nga njeriu, mirëpo janë me material të natyrës. Janë ushqim themelor për kafshët, rezervë për dimër. Më bëjnë të mendoj për vargun biblik - 'i gjithë mishi është bar' - që na përkujton se duhet t'i çmojmë jetët tona dhe t'i vendosim gjërat në perspektivë, të përqendrohemi në çështjet e rëndësishme të jetës sa jemi gjallë. Ka shumë lidhje, anekdota dhe frazeologji që kanë të bëjnë me mullarë edhe në shqip edhe në anglisht, e kjo është vetëm një prej tyre", - ka sqaruar ajo.

**URTËSI SOT E MOT**

Një ekspozitë personale e Lala Meredith-Vulës, nën titullin "Urtësi sot e mot", që bart këta dy projekte çelet në Muzeun Kombëtar të Fotografisë "Marubi" në Shkodër më 20 tetor 2017. E kuruar nga Monika Szewczyk, një ndër më të mirat sot në fushën e artit bashkëkohor, një njoftim i "Marubit" shënon se fjalët që karakterizojnë ekspozitën e Lala Meredith-Vula në Muzeun Marubi në Shkodër i gjejmë të shkruara mbi një pankartë, në njërën nga fotografitë që artistja shqiptaro-angleze shkrepi në Vranjevc të Prishtinës, më 4 maj 1990. Ato shprehin parimet që udhëheqin një transformim historik delikat brenda një komuniteti. Këto fjalë duket sikur përkojnë me të gjithë punën artistike të Meredith-Vula- e cila na paraqitet në të njëjtën kohë imediate dhe e çdokohshme, duke u integruar me proceset e ngadalshme që kërkojnë një shoqëri të gatshme për të pranuar një ndryshim të tillë si dhe bashkëveprim me tokën, duke përfshirë këtu edhe materialet natyrore që ajo ofron. Në gusht 1988, katër ditë pas instalimit të ekspozitës së famshme, Freeze me studentët e artit të Goldsmith, Lala Meredith-Vula la Londrën (qytet ku ishte vendosur në moshën katërvjeçare pas ikjes nga Sarajeva) për të shkuar në fshatrat kosovare, ku ajo filloi të fotografonte mullarët. Në këto forma agrare, ajo kishte gjetur "thelbin e veprës së artit". E nëse dëshironte të rilidhej me atdheun e saj, një dëshirë e tillë abstrakte duhej të rrënjosej diku thellë në tokë, ashtu si vetë mullarët. Pas tri dekadash dhe qindra fotografish, projekti vazhdon akoma. Por roli i Meredith-Vula si dëshmitare u transformua kur në vitin 1990, ajo mësoi mbi planet e pajtimit të gjaqeve në rajonin ku kishte fotografuar mullarët. Duke vënë mënjanë për pak kohë magjepsjen nga skulpturat rurale, ajo e orientoi objektivin e saj drejt qindra njerëzve që grumbulloheshin nën drejtimin e folkloristit dhe studiuesit Anton Çeta (1920-1995), për të përmbyllur në mënyrë ceremoniale, gjakmarrje që kishin vazhduar për shekuj të tërë, duke paralizuar kështu edhe komunitetet.



Posteri i ekspozitës

Dy seritë më përfaqësuese të Lala Meredith-Vula - Haystacks (Mullarët) dhe Blood Memory (Kujtesë Gjaku)- janë sjellë për të ndërvepruar me hapësirën e Muzeut Marubi. Përzgjedhje fotografish nga këto dy punë janë ekspozuar në Athinë dhe Kassel, në kuadër të ekspozitës ndërkombëtare "documenta 14". Megjithatë, ekspozita që po ju paraqesim, përbën një rast unikal për t'i parë të dyja seritë të ekspozuara së bashku. Përtej tyre, një imazh historik - ai i fotografisë së Kel Marubit në ceremoninë e ngritjes së flamurit në Kalanë e Shkodrës më 19 mars 1914, pjesë e ekspozitës "Rroftë!", kuruar nga Blerta Hoçia - është përfshirë këtu për të hapur një dialog mes imazheve unike të Meredith-Vula me trashëgiminë e pasur të dinastisë Marubi si dhe me historikun e ekspozitës të këtij muzeu, të themeluar në nderim të tyre. Bashkëbisedimet e hapura janë shumë të rëndësishme për artin dhe për ndërtimin e ekspozitave. Edi Hila, piktori i mirënjohur shqiptar komenton: "Lala ndërton një dialog me secilin nga mullarët. Ata personifikojnë atë çfarë Lala ka parë dhe ç'ka i kanë thënë asaj." Ndërkohë, pjesëmarrja e Meredith-Vula në "documenta 14" si dhe ekspozita e saj në Muzeun Marubi u mundësua falë Erzen Shkollolit, i cili në rolin e tij si këshilltar kuratorial në "documenta 14" ishte i pari që ia prezantoi punën e fotografes, ekipit të kuratorëve të "documenta 14".

**MBI ARTISTEN**

Lala Meredith-Vula ka lindur në Sarajevë në 1966 nga një baba kosovar dhe një nënë angleze. Në vitet '70 u zhvendos në Britaninë e Madhe. Studioi Artet e Bukura në "Goldsmiths' College" pranë Universitetit të Londrës (1985/88). Ekspozita e saj e parë u organizua në kuadër të ekspozitës "Freeze" të artistit të mirënjohur britanik Damien Hirst (Londër 1988), ekspozitë e famshme kjo për lançimin e artistëve të rinj britanikë. Ajo ka përfaqësuar Shqipërinë në Bienalen e 48-të të Venecias në vitin 1999. Ka punuar për shumë ekspozita vetjake, përfshirë këtu Photographers' Gallery, Londër si dhe ekspozita të tjera në Gjermani, Itali e Shqipëri. Meredith-Vula ka marrë pjesë edhe në ekspozita në grup në Britaninë e Madhe, SHBA, Kinë dhe vende të tjera europiane. Në vitin 2016 ka qenë një ndër kandidatet e përzgjedhura për Deutsche Börse Foundation Photography Prize 2016 për ekspozitën e saj "Kujtesë gjaku" në Galerinë e Arteve të Kosovës. Në vitin 2017 punët e saj u përzgjodhën për "documenta 14" në Athinë dhe Kassel.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**BANKA E SHQIPERISE**
**DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT**
**SEKTORI I PROKURIMIT**

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: ***"Shërbimi i pastrim-higjienizimit dhe i dezinfektimit të ambienteve të Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"***.

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 13,300,000 Lekë"**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkese me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi te keni bërë paraprakisht pagesën e pakthyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: ***"Shërbimi i pastrim-higjienizimit dhe i dezinfektimit të ambienteve të Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"***

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 31 Tetor 2017, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Ambasada e Republikës Federale të Gjermanisë Tiranë

deutscher oktober tetori gjerman

INFO-TAG

Panairi i informacionit rreth Gjermanisë

Shkollime, studime, praktika, bursa, kërkim shkencor, mësimi i gjermanishtes, etj.

**Kur?** **E premte, 13 tetor 2017**
**mund të vini të informoheni në çdo kohë nga ora 10:00 deri në 16:00**

**Ku?** **Rrjeti i Informimit të Bashkimit Evropian,**
**Blv. "Dëshmorët e Kombit", Pallati i Kongreseve, Tiranë.**

Për informacione të mëtejshme vizitoni: **www.tetori-gjerman.com**

Study in Germany Land of Ideas www.study-in.de
DAAD Deutscher Akademischer Austauschdienst German Academic Exchange Service
GOETHE-ZENTRUM KOOPERATIONSPARTNER
GOETHE INSTITUT
oa OeAD
IPS
ösd

### Dokumentet duhet të dorëzohen brenda tre muajve për këstin e parë dhe të dytë

# Ish-të përndjekurit, 2.000 trashëgimtarët që përfitojnë dëmshpërblim

## Ministria e Financave: Fëmijët dhe nipërit e ish-të dënuarve të plotësojnë dosjet

Ornela Manjani

Ministria e Financave ka publikuar listën e kategorisë joparësore në radhët e ish-të përndjekurve politikë që mund të trajtohen me dëmshpërblim, por që sipas këtij dikasteri duhet të sjellin dokumentet e nevojshme. Bëhet fjalë për listën e kategorisë joparësore, për trashëgimtarët, rreth 2.000 përfitues, të cilët do të marrin dëmshpërblim, por më parë duhet të plotësojnë dosjen me dokumente. "Gazeta Shqiptare" publikon listën e plotë së bashku me analizën e dokumentacionit për çdo dosje, si për përfituesit e këstit të parë ashtu edhe për ata të këstit të dytë. Dokumentet për trajtimin me dëmshpërblim pas shqyrtimit të juristit, duhet të dorëzohen brenda tre muajve.

**DOKUMENTET**

Të gjithë trashëgimtarët e ish-të dënuarve duhet të sigurohen pranë bankës në të cilën kanë hapur llogarinë që llogaria e tyre është aktive. Në rast se llogaria nuk është aktive, shuma e dëmshpërblimit kthehet mbrapsht në buxhet, duke sjellë vonesa dhe ndërlikime të panevojshme. Kur kemi ndryshim të identitetit, emër/mbiemër, apo në rastet kur në certifikatë ndryshon emri ose mbiemri, qoftë edhe me një germë të vetme në krahasim me dëshminë e trashëgimisë apo prokurës, kartës së identitetit dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm, duhet medoemos që në të gjitha dokumentet emrat të jenë të njëjtë me atë që është shkruar në certifikatën e lëshuar nga gjendja civile. Në rast se ka transkriptime të gabuara gjatë kohës nga një certifikatë e një periudhe të caktuar, atëherë këto ndryshime duhet të pasqyrohen brenda formatit të certifikatës apo edhe të një vërtetimi të veçantë të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Ligji parashikon edhe rastet e ekzekutimeve pa gjyq. "Në rastet e ekzekutimeve kapitale pa gjyq, është i domosdoshëm një vendim fakti gjykate që vërteton vdekjen, plus një certifikatë negative të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Në rastet kur për arsye të njohura në gjendjen civile nuk ekzistojnë dokumente të periudhës përkatëse dhe ky fakt vërtetohet nga gjendja civile, i interesuari është i detyruar të bëjë një gjyq fakti, të cilin edhe në këtë rast si në pikën më lart, duhet ta shoqërojë me një certifikatë negative", thuhet në njoftimin që Ministria e Financave bën për të sqaruar trashëgimtarët e ish-të dënuarve që nuk kanë marrë ende dëmshpërblimin.

## KESTI I PARË

Shënim: Kur dokumentacioni është I rregullt shënohet me V, kur mungon shënohet me X, kur kanë autorizuar me prokurë shënohet me P.

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 18620 | RRAHIM | DOGJANI | | | XHELADIN | | | | | | | | | | | V | V | V |
| | | | | RASIM | XHELADIN | DOGJANI | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | KAMBER | RASIM | DOGJANI | | | | V | V | | |
| 9211 | HUZNI | BELLO | | | NEVRUZ | | | | | | | | | | | V | V | V |
| | | | | HABIL | HUZNI | BELLO | | | | | | | | V | V | | | |
| | | | | NEXHMIJE | HUZNI | ONJEA | | | | | | | | V | V | | | |
| | | | | VERIE | HUZNI | MULLAJ | | | | | | | | V | V | | | |
| | | | | KOZETA | HUZNI | MUXHAJ | | | | | | | | V | V | | | |
| | | | | ELI | HUZNI | KARAGJOZI | | | | | | | | V | V | | | |
| 13107 | REXHO | ZACAJ | | | ARIF | | | | | | | | | | | V | V | V |
| | | | | BAJAME | REXHO | ALIAJ | | | | | | | | | | V | V | V |
| | | | | | | | | | SKENDER | XHAFER | ALIAJ | | | V | | | | |
| | | | | | | | | | FATOS | XHAFER | ALIAJ | | | V | V | | | |
| | | | | | | | | | ARTA | XHAFER | DALARDHA | | | V | | | | |
| | | | | ALI | REXHO | ZACAJ | | | | | | | | | | V | V | V |
| | | | | | | | | | EDMONDA | ALI | KAMBO | | | V | | | | |
| | | | | | | | | | SHKELZEN | ALI | ZACAJ | | | V | V | | | |
| | | | | | | | | | ARJANA | ALI | LLIXHA | | | V | | | | |
| | | | | XHEMIL | REXHO | ZACAJ | | | | | | | | V | V | | | |
| | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | THELLEZA | SHAHIN | ZACAJ | | | V | V | | | |
| 3309 | JORGJI | DHAMI | | | ALEKS | | | | | | | | | | | V | V | V |
| | | | | DHORKA | JORGJI | VOGLI | | | | | | | | | | V | V | V |
| | | | | | | | | | VASIL | JOSIF | VOGLI | | | V | | | | |
| | | | | | | | | | PAVLLI | JOSIF | VOGLI | | | V | | | | |
| | | | | | | | | | THOMA | JOSIF | VOGLI | | | V | | | | |
| | | | | | | | | | MIRELA | JOSIF | DHIMO | | | V | | | | |
| | | | | VANGJEL | JORGJI | DHAMI | | | | | | | | V | V | | | |
| | | | | LUIZA(LLUIZA) | JORGJI | RUÇO | | | | | | | | V | | | | |
| 2035 | DALIP | SHESHALLIU | | | QERIM | | | | | | | | | | | V | V | V |
| | | | | ISMAIL | QERIM | SHESHALLIU | | | | | | | | X | X | | | |
| | | | | FEJZI | QERIM | SHESHALLIU | | | | | | | | | | V | V | X |
| | | | | ZENJEL | QERIM | SHESHALLIU | | | | | | | | | | X | V | V |
| 13085 | VAT | GJONI | | | MARK | | | | | | | | | | | V | V | V |
| | | | | MRI | VAT | DAKAJ(MANI) | | | | | | | | V | V | | | |
| | | | | GJYSTE | VAT | DAKAJ(MANI) | | | | | | | | V | V | | | |
| | | | | PREL | VATE | MANI | | | | | | | | V | V | | | |
| | | | | KOLE | VAT | MANI | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | FREDI | KOLE | MANI | | | V | V | | | |
| | | | | TEREZE | VAT | NIKA | | | | | | | | | | V | V | |
| | | | | | | | | | PREKE | LAZER | NIKA | | | V | V | | | |
| | | | | | | | | | MARIJE | LAZER | MARTINI | | | V | X | | | |
| | | | | | | | | | GJELINE | LAZER | NDOU | | | V | V | | | |
| | | | | | | | | | FLORA | LAZER | SHKOZA | | | V | V | | | |
| | | | | | | | | | LIZE | LAZER | RRASA | | | V | V | | | |
| | | | | | | | | | TONE | LAZER | BOSHESKA | | | V | V | | | |
| | | | | | | | | | ROZE | LAZER | KAPTANAJ | | | V | X | | | |
| 3788 | HAMIT | KARAMETA | | | MEHMET | | | | | | | | | | | V | V | V |
| | | | | DITURIJE | HAMIT | SHAQLLI | | | | | | | | V | V | | | |
| | | | | MARGARITA(AZBIJE) | HAMIT | MUCKA | | | | | | | | | | V | V | X |
| 21361 | SALI | MUJA | | | SHPEND | | | | | | | | | | | V | V | V |
| | | | | REXHEP | SHPEND | MUJA | | | | | | | | X | X | | | |
| | | | | MEHMET | SHPEND | MUJA | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | KADRI | MEHMET | MUJA | | | V | | | | |
| | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | HYSNI | MEHMET | MUJA | | | V | V | | | |
| 21354 | PREN | NDOJ-MEHILLI | | | NIKOLL | | | | | | | | | | | V | V | V |
| | | | | NDOK | PREN | LLESHI | | | | | | | | V | V | | | |
| | | | | NDUE | PREN | LLESHI | | | | | | | | | | V | V | X |
| | | | | | | | | | ARBEN | NDUE | LLESHI | | | V | V | | | |
| | | | | GJYSTE | PREN | PJETRAJ | | | | | | | | V | V | | | |
| | | | | AGE | PREN | LLESHAJ | | | | | | | | | | V | V | V |
| 18117 | MATI | NDOJ | | | PREND | | | | | | | | | | | V | V | V |
| | | | | LIZA | MATI | LIKA | | | | | | | | V | V | | | |
| | | | | DRANE | MATI | NIKOLLI | | | | | | | | | | V | V | V |
| | | | | | | | | | BARDHOK | MARK | NIKOLLI | | | V | V | | | |
| | | | | | | | | | MRIKE | MARK | VOKRRI | | | V | | | | |
| | | | | | | | | | DILE | MARK | MARKU | | | V | | | | |
| | | | | | | | | | BIB | MARK | NIKOLLI | | | V | | | | |
| | | | | | | | | | DAVE | MARK | MARKU | | | V | | | | |
| | | | | | | | | | BARDHE | MARK | NIKOLLI | | | V | | | | |
| | | | | | | | | | DALINA | MARK | GJOKA | | | V | | | | |
| | | | | | | | | | PRENDA | MARK | ZEFI | | | V | | | | |
| | | | | | | | | | KASTRIOT | MARK | NIKOLLI | | | V | | | | |

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1487 | LAZE | GJINI | | | NDONI | | | | | | | | | | | V | V | V |
| | | | | TINE | LAZE | MEHILLI | | | | | | | | | | X | X | V |
| | | | | | | | | | LLAZAR | NAUN | MEHILLI | | | | | | | V |
| | | | | | | | | | LEFTE | NAUN | SOTA | | | V | V | | | |
| | | | | | | | | | DRITA | NAUN | MEHILLI | | | V | V | | | |
| | | | | | | | | | OLIMBI | NAUN | QOSE | | | V | V | | | |
| | | | | | | | | | MARIJE | NAUN | BITA | | | V | V | | | |
| | | | | | | | | | DONIKA | NAUN | SAKO | | | V | V | | | |
| | | | | | | | | | NIKOLLAQ | NAUN | MEHILLI | | | V | V | | | |
| | | | | FANIJE | LAZE | GJINI | | | | | | | | X | X | | | |
| | | | | THEMI | LAZE | GJINI | | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | VASIL | THEMI | GJINI | | | X | X | | | |
| | | | | | | | | | VANGJEL | THEMI | GJINI | | | V | V | | | |
| | | | | | | | | | TODI | THEMI | GJINI | | | X | X | | | |
| | | | | | | | | | ANDREA | THEMI | GJINI | | | V | V | | | |
| | | | | | | | | | MARGE (MARGARITA) | THEMI | GJINI | | | V | V | | | |
| | | | | LENA | LAZE | GJINI | | | | | | | | | | | X | |
| | | | | | | | | | ARISTIDH | LLAMBI | DHIMA | | | V | V | | | |
| | | | | | | | | | SPIRO | LLAMBI | | | | X | X | | | |
| | | | | | | | | | VANGJELINA | LLAMBI | CILI | | | V | V | | | |
| 7475 | BERAM | ÇAPANI | | | HAXHI | | | | | | | | | | | V | V | V |
| | | | | ANA(HANKE) | BERAM | LIKA | | | | | | | | V | V | | | |
| 16117 | SOKOL | VLADAJ | | | KOL | | | | | | | | | | | **V** | **V** | **V** |
| | | | | ZEF | SOKOL | VLADAJ(MEGJAJ) | | | | | | | | **V** | **V** | | | |
| 20069 | MARK | TOÇI | | | SOTIR | | | | | | | | | | | V | V | V |
| | | | | ILIA | SOTIR | TOÇI | | | | | | | | V | V | | | |
| | | | | VANGJEL | SOTIR | TOÇI | | | | | | | | | | V | V | V |
| | | | | | | | | | DORINA | VANGJEL | TOÇI | | | V | V | | | |
| | | | | | | | | | PLARENT | VANGJEL | TOÇI | | | V | V | | | |
| 3616 | ZEF | PERSHPALAJ | | | MARK | | | | | | | | | | | V | V | V |
| | | | | VITORE | ZEF | DELIJA | | | | | | | | V | X | | | |
| | | | | SOKOL | ZEF | PERSHPALAJ | | | | | | | | X | X | | | |
| | | | | LULE | ZEF | DEMAJ | | | | | | | | V | V | | | |
| | | | | LULE | ZEF | VUKSANI | | | | | | | | V | V | | | |
| | | | | BARDHE | ZEF | PERSHPALAJ | | | | | | | | X | X | | | |
| | | | | MARK | ZEF | PERSHPALAJ | | | | | | | | X | X | | | |
| 13330 | AMZA | BODURI | | | SALI | | | | | | | | | | | V | V | V |
| | | | | RESMIJE | | BODURI | | | | | | | | | | V | V | X |
| | | | | MUHAMET | AMZA | BODURI | | | | | | | | | | V | X | X |
| | | | | LIRI | AMZA | NURELLARI | | | | | | | | V | V | | | |
| | | | | SHPRESA | AMZA | BODURI | | | | | | | | V | V | | | |
| | | | | SALI | AMZA | BODURI | | | | | | | | V | V | | | |
| | | | | LEFTER | AMZA | BODURI | | | | | | | | V | V | | | |
| | | | | HENA | AMZA | KALEMI | | | | | | | | V | V | | | |
| | | | | MAJLINDA | AMZA | KUSHOVA | | | | | | | | V | V | | | |
| 16899 | MARK | KOLNIKAJ | | | TOM | | | | | | | | | | | V | V | V |
| | | | | PRENDE | MARK | PRECETAJ | | | | | | | | V | | | | |
| | | | | PASHKO | MARK | KOLNIKAJ | | | | | | | | | | V | V | V |
| | | | | | | | | | ZEF | PASHKO | KOLNIKAJ | | | V | | | | |
| | | | | LUIGJ | MARK | KOLNIKAJ | | | | | | | | V | | | | |
| | | | | GJEKE | MARK | KOLNIKAJ | | | | | | | | V | | | | |
| | | | | LULE | MARK | BZHETAJ | | | | | | | | | | V | V | V |
| | | | | | | | | | GJOVALIN | MARTIN | BZHETAJ | | | V | | | | |
| | | | | | | | | | ARTA | MARTIN | HASANAJ | | | V | | | | |
| | | | | VITORE | MARK | BZHETAJ | | | | | | | | V | | | | |
| | | | | GJOVALIN | MARK | KOLNIKAJ | | | | | | | | V | | | | |
| | | | | MARASH | MARK | KOLNIKAJ | | | | | | | | V | V | | | |
| 21176 | IZET | XHANI | | | | | | | | | | | | | | V | V | X |

| NR. DOSJES | EMER | MBIEMER | VKM NR. | Emer | ATESIA | MBIEMER | DATELINDJA | VENDLINDJA | EMERI | ATESIA | MBIEMRI | DATELINDJA | VENDLINDJA | KOPJE TE LETER NJOFTIM | NUMER PERSONAL LLOGARI BANKARE | CERTIFIKATE VDEKJE | CERTIFIKATE E TRUNGUT FAMILJAR | DESHMI TRASHGIMIE |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **8274** | **Nuri** | **Rrapaj** | **509** | | **Namik** | | | | | | | | | | | V | V | V |
| | | | | Floresha | Sami | Rrapaj | | | | | | | | | | V | V | V |
| | | | | Namik | Arap | Rrapaj | | | | | | | | V | V | | | |
| | | | | Hektor | Namik | Rrapaj | | | | | | | | V | V | | | |
| | | | | Virjon | Namik | Rrapaj | | | | | | | | V | V | | | |
| | | | | Benet | Namik | Rrapaj | | | | | | | | V | V | | | |

Lista emërore në Shkodër, Malësi e Madhe dhe Pukë. Kompensimi fizik e financiar, në rend kronologjik

# ATP, statusi i secilës pronë në Shkodër

## *Emrat e pronarëve, sipërfaqja e pretenduar dhe sa kompensohet*

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtimit të Pronës ka përditësuar regjistrin e saj elektronik për dosjet e pronave në të gjithë vendin. Çdo trashëgimtar pronash ka mundësi të lexojë në "Gazetën Shqiptare" statusin e dosjes së tij dhe problematikën e dokumenteve që mund të ketë secili pronar. Regjistri elektronik mban të dhëna të detajuara për çdo aplikim dhe çdo proces që ka ndodhur me pronat që nga viti 1993 dhe deri tani për qarkun e Shkodër. Secila nga dosjet përmban emrin e subjektit të shpronësuar si dhe emrin e subjekteve që e pretendojnë atë pronë. Në dosje pasqyrohen sipërfaqja e pretenduar si dhe lloji i pasurisë, sipërfaqja e njohur, sipërfaqja e kthyer apo e kompensuar. Ndërkohë që pasqyrohen edhe të gjitha vendimet e Komisioneve dhe Zyrave Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për secilin subjekt, bashkë me vendimet gjyqësore dhe problematikat e secilës dosje. "Gazeta Shqiptare" nis sot publikimin e pjesës së dytë të listës së veprimeve që janë kryer me dosjet e pronave të qarkut të Shkodër. Të gjithë të interesuarit njihen gjithashtu edhe me problematikat që mund të ketë dosja e tyre, siç është mungesa e dokumenteve të caktuara. Ndërkohë, Agjencia e Trajtimit të Pronave ka marrë në shqyrtim dosjet në qarkun e Elbasanit, të cilat janë në proces shqyrtimi. Regjistri i dosjeve në shqyrtim pasqyron numrin e dosjes, emrin e subjektit të shpronësuar, kërkuesin, llojin e pasurisë si dhe të dhënat në lidhje me sipërfaqen e njohur, sipërfaqen e kthyer dhe sipërfaqen e kompensuar. Në regjistër janë edhe të dhënat për çdo dosje për vendimet e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si dhe problematika që ka çdo dosje, e cila pasqyron mangësinë në dokumentacion. Sot publikohet regjistri elektronik i pronave në qarkun e Shkodrës, ku përfshihen Shkodra, Malësia e Madhe dhe Puka. Dosjet ndodhen në Agjencinë e Trajtimit të Pronave në proces shqyrtimi dhe do të trajtohen me ligjin e ri. Vendimi do të merret sipas rendit kronologjik të kërkesave dhe kompensimi do të shpërndahet sipas këtij rendi, me përjashtim të rasteve kur subjekti kërkon të përfitojë nga pagesa e përshpejtuar, ose kërkon të jetë pjesë e tenderit për kompensimin fizik në bazë të pronave që ka vënë në dispozicion ATP-ja. ATP-ja do t'i japë përparësi kompensimit të truallit. Kompensimi për ish-pronarët për tokën truall, sipas zërit kadastral të vitit 1945 dhe hartës së vlerës së tokës që është në fuqi do të kryhet me para. Kufiri i caktuar nga ligji është 50 milionë lekë për çdo vendim të njohur.

### LISTA E VEPRIMEVE QË JANË KRYER ME DOSJET E PRONAVE TË QARKUT TË SHKODRËS (PJESA E DYTE)

*(Vijon nga numri i djeshëm)*

| Emri (Subjekti I shpronësuar) | Mbiemri (Subjekti I shpronësua) | Emri (Subjekti Kërkues) | Mbiemri (Subjekti Kërkues) | Sip. E pretenduar, m2 & lloji I pasurise | Zona Kadastrale | NR I Vendimit I KKKP, ZRKKP | Sip. E Njohur/ Mosnjohje M2 | Sip. E Kompensuar M2 | Problematika |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Hile | Rrotaj | Hile | Rrotaj | 850m2 truall | Bushat / 1329 | 75/1 | 850 | | Ka vertetim kadastral Ka harte + vertetim kryeplaku Njihet e drejta e parablerjes se objektit qe ndodhet mbi nje sip 500 m² brenda sip. Totale te njohur me kete vendim. |
| Veli | Lahi | Ahmet | Lahi | 5900m2 truall | Gur I Zi / 1989 | 72 | 5900 | | Ka vertetim kadastral Ka harte |
| Daut | Hasi | Daut | Hasi | 5640m2 truall | Rrethina Dobrac / 1495 | 71 | 5640 | | Ka vertetim kadastral Ka harte sip. 5640 I njihet ne baze te nenit 21 te ligjit 7968, mbi te ndodhen objekte te ndertuara nga shteti |
| Muho | Smajli | Muho | Smajli | 4000m2 truall | Rrethina Shtoj I Ri / 3428 | 70 | 4000 | 4000 | Ka vertetim kadastral Ka harte |
| Kasem | Bushati | Remzie | Bushati | 8000m2 truall | Bushat / 1329 | 390 | 3600 | 3600 | Ka vertetim kadastral Ka harte |

| Emri (Subjekti I shpronësuar) | Mbiemri (Subjekti I shpronësua) | Emri (Subjekti Kërkues) | Mbiemri (Subjekti Kërkues) | Sip. E pretenduar, m2 & lloji I pasurise | Zona Kadastrale | NR I Vendimit I KKKP, ZRKKP | Sip. E Njohur/ Mosnjohje M2 | Sip. E Kompensuar M2 | Problematika |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Jakup | Hoxha | Eljaz | Hoxha | 2000m2 truall | Muriqan / 2740 | 389 | 2000 | | Ka vertetim kadastral Ka harte Ka VFJ I njihet e drejta e parablerjes |
| Hajdar | Nurja | Bihana | Capnage | 500m2 truall | Bushat / 1329 | 388 | 500 | 500 | Ka vertetim kadastral Ka harte |
| Zef | Gocaj | Zef | Gocaj | 1500m2 truall | Anaemali t Obot / 2819 | 387 | 1500 | 1500 | Ka VFJ Ka harte |
| Broz | Gocaj | Broz | Gocaj | 1500m2 truall | Anaemali t Obot / 2819 | 386 | 1500 | 1500 | Ka VFJ Ka harte |
| Selman | Laci | Selman | Laci | 250m2 truall | Fshati Mlloje, Lac / 8598 | 385 | 250 | 250 | Ka Vert.Kadastral Ska harte |
| Hysni | Sokoli | Virtyt | Sokoli | 2050m2 truall 1050m2 truall 200m2 truall | Shkjez Bushat / 3389 | 384 | 3300 | 3300 | Ka VFJ Ka harte |
| Prend | Bishaj | Prend | Bishaj | 300m2 truall | Mazrek Gur I Zi / 2624 | 383 | 300 | 300 | Ka Vert.Kadastral Ska harte |
| Pjeter | Ndoka | Gjon | Ndoka | 16500m2 truall | Lac,Vau Dejes / 8598 | 382 | 11100 | 6100 | Ka Vert.Kadastral Ka harte |
| Ismail | Alibali | Halim | Osmani | 10300m2 truall | Hajmel / 1920 | 381 | 10300 | 10300 | Ka vertetim arkivi Ka harte |
| Zef | Nika | Ndrek | Nikaj | 15000m2 truall | Lac,Vau Dejes / 8598 | 380 | 10500 | | Ka vertetim arkivi Ka harte I njihet e drejta e parablerjes |
| Daut | Mehmeti | Sabri | Kulli | 8800m2 truall | Pacram Pistull / 2851 | 379 | 8800 | 8800 | Ka vertetim arkivi Ka harte |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Gjush | Deda | Klara | Noga | 360m2 truall | Shiroke / 8591 | 378 | 100 | 100 | Ka vertetim arkivi Ka harte |
| Musa ; Shyqyri | Nehani | Ahmet | Nehani | 10100m2 truall | Bushat / 1329 | 377 | 10800 | 1050 | Ka vertetim arkivi Ka harte Sip. 4750 njihet sipas nenit 21 te ligjit 7698 |
| Tom | Lulgjuraj | Mark | Lulgjuraj | 1000m2 truall | Grude e Re Shtoj / 1869 | 376 | 1000 | | Ka vertetim arkivi Ka harte I njihet e drejta e parablerjes |
| Kisha Ortodokse | | Kisha Ortodokse | | 8200m2 truall | Rrethina / 1495 | 375 | 8200 | 50 | Ka VFJ + Harte Sip 1800 m² I njihet me parablerje |
| Zef | Jakaj | Zef | Jakaj | 24000m2 truall | Lac,Vau Dejes / 8598 | 374 | 11400 | 6400 | Ka vert.kadastral Ka harte |
| Lula | Dushkja | Luke | Dushoviq | 342m2 truall | Hot I ri / 1965 | 373 | 342 | 342 | Ka vert.kadastral Ka harte |
| Frrok | Marku | Ndoc | Simoni | 8800m2 truall | Hajmel / 1920 | 372 | 2100 | 2100 | Ka vert.kadastral Ka harte |
| Mark | Peniku | Mati | Peniku | 990m2 truall | Fshati Rrenc Gur I Zi / 1989 | 371 | 990 | | Ka vert.kadastral Ka harte I njihet parablerja per objektin qe ze sip. 320 m² |
| Ndreke | Kurbini | Lucije | Kurbini | 4500m2 truall | Hajmel / 1920 | 370 | 3000 | | Ka VFJ Ka Harte |
| Halil | Hoxhaj | Shaqir | Duli | | Mjede / 2702 | 511 | Vendim Negativ | | Ka vert.kadastral Vendim Negativ |
| Mati | Koliqi | Mati | Koliqi | 800m2 truall | Shiroke / 8591 | 510 | 800 | | Ka VFJ + Harte |
| Tom | Ndoci | Luk | Brungaj | 250m2 truall | Gonsiqe Hajmel / 1799 | 509 | 250 | 250 | Ka vert.arkivi |
| Ndreke | Simoni(Ceklijej) | Tonin | Ceklijej | 398m2 truall | Shiroke / 8591 | 506 | 398 | 398 | Ka VFJ + Harte |
| Sulejman ; Fadile | Avdia | Meliha | Ulqini | 5 dy truall | Guci e RE / 1880 | 505 | 5000 | 5000 | Ka VFJ + Harte |
| Hil | Simoni | Hil | Simoni | 9.6dy truall | Lac,Vau Dejes / 8598 | 504 | 9600 | 9600 | Ka VFJ + Harte |
| Ndrec | Gjoka | Ejll | Gjoni | 15000m2 truall | Lac,Vau Dejes / 8598 | 503 | 15000 | 500 | Ka VFJ + Harte |
| Jak | Doda | Drande | Kola | 250m2 truall | Lac,Vau Dejes / 8598 | 502 | 250 | 250 | Ka VFJ + Harte |
| Mark | Shytani | Gjoke | Shyti | 3000m2 truall | Theth Shale / 3597 | 507 | 3000 | | Ka VFJ + Harte I njihet e drejta e parablerjes |
| Shyqyri | Muja | Shyqyri | Muja | papercaktuar | | 519 | vendim negativ per mungese dokumentacioni | | Ska Dokumentacion Ska harte |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Hasan | Hoxha | Hasan | Hoxha | Pa sip. | Berdice / 1157 | 518 | Vendim Negativ | | Ska Dokumentacion Ska harte |
| Fetah | Lika | Fetah | Lika | 700m2 truall 25 000 m² truall | Mjede / 2702 | 517 | Vendim Negativ | | Ska Dokumentacion Ska harte |
| Enver | Pajtesa | Enver | Pajtesa | Pa sip. | Dobrac / 1495 | 516 | Vendim Negativ | | Ska Dokumentacion Ska harte |
| Lac | Hysa | Lac | Hysa | 22000 m² truall | Golem / 1790 | 515 | 22000 | 20500 | Ka VFJ + Harte Sip 1500 m² njihet me parablerje |
| Tone | Fishta | Tone | Fishta | 15.500m2 t.truall | Shiroke / 8591 | 514 | 8000 | | Ka VFJ + Harte |
| Ndue ; Ndoc | Curri | Ndue | Curri | 3600m2 truall | Arre / 1048 | 513 | 3600 | 3600 | Ka VFJ + Ska Harte |
| Shah | Abdullahi | Sabri | Abdullai | 202m2 truall | Mjede / 2702 | 512 | 202 | | Ka vert.kadastre Ka harte I njihet e drejta e parablerjes |
| Shuk | Vasa | Shuk | Vasa | 5350m2 truall | Gur I Zi / 1989 | 269 | 3700 | 1100 | Ka vert.pronesie Ka vert.kadastral Vendimi nuk u ankimua Mbi sip. 600 m² njihet e drejta e parablerjes |
| Zef | Koka | Zef | Koka | Pa sip. | Shiroke Rrethina / 8591 | 260 | | | Ka vert.pronesie Ka Skica Vendimi nuk u ankimua I njihet parablerja mbi objektin ne sip. 132 brenda oborrit te shtepise |
| Zef | Shestani | Marian | Shestani | 661m2 truall | Shiroke Rrethina / 8592 | 279 | 318 | | Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua |
| | Ndrekaj(Kola) | Zef | Ndreka | 5000m2 truall | Stajke Bushat / 3506 | 278 | 5000 | 5000 | Ka vert.pronesie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua |
| Jak ; Mrike | Dushkja | Ded | Dushkja | 500m2 truall | Berdice / 1157 | 277 | 500 | 500 | Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua |
| Smajl | Carku | Ilir | Qarku | 5000m2 truall | Mjede / 2702 | 276 | 5000 | 1000 | Ka vert.pronesie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua |
| Shaban | Dini | Shyqyri | Dini | 11000m2 truall | Mjede / 2702 | 275 | 10400 | 2700 | Ka vert.pronesie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua |

*(Vijon nesër)*

Opinioni i Ditës

# Sfidat e NATO-s

Ilir Kalemaj

*(Vijon nga faqja e parë)*

... e tij të "Akseve të së Keqes", ka nja 70 e kusur bomba atomike dhe po bën prova me bombën me hidrogjen, si dhe dyshohet të ketë kapacitetet lançuese duke kërcënuar përtej rrezes së gadishullit korean, vendin udhëheqës të NATO-s, Shtetet e Bashkuara, nëpërmjet kërcënimit të sulmit mbi bazën ushtarake të Guam-it në Paqësor apo edhe Japoninë. Neni i 5-të i NATO-s "një për të gjithë, të gjithë për një" ka vetëm një aplikim të tijin në praktikë, që mori jetë pas 11 shtatorit të sulmeve terroriste mbi 2 kullat binjake në Nju-Jork dhe i hapi rrugë ndërhyrjes me mbështetje të gjerë në Afganistan për të mposhtur Al-Kaedën dhe regjimin taleban që e mbështeste.

Nëse ISIS-i është një kërcënim në tërheqje, të paktën në luftën frontale apo guerilase në Lindjen e Mesme, një kërcënim i ri është shfaqur qysh vjet, në formën e shteteve të paqëndrueshme dhe në kaos total si Libia, ku grupe të ndryshme terroriste kanë marrë në kontroll bregdetin dhe trafikun e qenieve njerëzore drejt Italisë, Greqisë apo Spanjës, dhe mandej në pjesën tjetër të vendeve anëtare të NATO-s dhe Bashkimit Europian. Një kërcënim ky në rritje që jo vetëm ka sjellë një fluks të jashtëzakonshëm njerëzish nga Afrika Veriore dhe Lindja e Mesme në dyert e Europës si refugjatë lufte duke shkaktuar një krizë demografike por edhe politike, por nga ana tjetër mbart gjithnjë rrezikun e infiltrimit të terroristëve, që si "ujq të vetmuar" apo celula të mbyllura kanë shkaktuar dhjetëra sulme terroriste në Europë vetëm gjatë viteve të fundit.

Ukraina është teatër tjetër i rrezikshëm mes ndërveprimit të NATO-s dhe Rusisë, ku marrëdhënia me këtë të fundit ka ardhur në përshkallëzim qysh prej Samitit të Varshavës vjet në korrik, ku një nga prioritetet e NATO-s në të ardhmen e afërt ishte the "restaurimi i dialogut NATO-Rusi për të shtuar transparencën dhe promovuar sigurinë europiane". Duket se tashmë situata është përshkallëzuar me stërvitjet ushtarake ruse që simulojnë luftë reale në Bjellorusi, kërcënimet ruse për vendet baltike dhe agravimet dhe tonet në rritje me Poloninë.



Ballkani Perëndimor është një tjetër aspekt shqetësues i përplasjeve gjeopolitike mes NATO-s dhe interesave strategjike të vendeve euroatlantike dhe Rusisë, ku vërejmë një ndarje sinorësh sipas vijave të vjetra të kufijve mes civilizimesh. Nga njëra anë aleanca pansllave e udhëhequr nga Rusia dhe me ndikim të fortë në Serbi, Republika Serbska, pjesën veriore të Malit të Zi dhe pjesën lindore në Maqedoni, nga ana tjetër një influencë e fortë euro-atlanticiste në Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi dhe, natyrisht, Kroaci dhe më gjerë.






## HOROSKOPI

### DASHI

Keni nevojë për një ndryshim ambienti që u rikthen entuziazmin ideve të reja që keni, për të mos humbur gjallërinë dhe entuziazmin, që ju shquajnë nga të tjerët. Më në fund erdhi një ditë e qetë: pikërisht ajo që ju duhet për të qëndruar më shumë me të dashurit tuaj.

### DEMI

Nuk është e thjeshtë të ruash përqendrimin te çështjet më urgjente, nëse nuk do t'ua ktheni me një "jo" strategjike atyre që do t'ju kërkojnë ndihmë. Kushtojini më shumë kohë vetes dhe pasioneve që keni, dhe shijoni gjërat e vogla që ju ofron jeta.

### BINJAKET

Duke mos u dashur të zgjoheni herët për të shkuar në punë, mund rrini të qetë dhe të mos lodheni shumë. Keni nevojë për të pushuar pak. Por nëse bie alarmi i orës, pasi edhe sot ju thërret detyra, mendoni të pini një kafe të mirë dhe do të merrni zemër.

### GAFORJA

Fjalët e bukura dhe vështrimet e ëmbla nuk ju mjaftojnë? Mos kërkoni shumë nga partneri, nëse nuk doni të krijoni tensione që nuk ka arsye të jenë. Të kënaqeni është e rëndësishme, nëse doni të ndërtoni themelet mbi të cilat të ngrini një raport të qëndrueshëm.

### LUANI

Keni zbuluar në personin e dashur një anë, ekzistencën e së cilës e keni shpërfillur? Nuk ka problem, do të shërbejë për ta bërë marrëdhënien tuaj në çift më të plotë. Gjatë kësaj periudhe jeni shumë të shpërqendruar: tregohuni të vëmendshëm, nëse do të angazhoheni në atë që bëni.

### VIRGJERESHA

Të favorizuar nga Saturni, zgjidhja e një çështjeje që ju shqetëson do të jetë e thjeshtë, si dhe sepse jeni të fortë nga besimi që ju japin shumë persona. Duke mundur të merrni nën kontroll situatën, do të keni çdo gjë nën vëzhgimin tuaj të kujdesshëm dhe vigjilent.

### PESHORJA

Në vend që të rrini i ngulitur te telefoni dhe rrjetet sociale, vendosni të dilni, nëse doni të bëni një takim romantik apo edhe vetëm thjesht për t'u argëtuar pak. Raste do të keni, por ndoshta ju mungon perceptimi për t'i vënë në pah në kohën e duhur.

### AKREPI

Falë mirësisë së Hënës në harmoni me Plutonin dhe Venusin, mund të keni më shumë vullnet për të përmirësuar fushën e ndjenjave dhe të dashurisë. Në shtëpi keni një atmosferë të qetë, duke qenë se dini si ta krijoni.

### SHIGJETARI

Ndjenja juaj për drejtësi do t'ju ndihmojë të zgjidhni me shpejtësi një çështje delikate, në të cilën nuk do të kishit dashur fare të ishit përfshirë. Pak rëndësi ka nëse mënyra juaj e të vepruarit nuk arrin të kënaqë gjithkënd. Ajo që ka rëndësi është integriteti juaj.

### BRICJAPI

Pozicionimi i Hënës në lidhje me Plutonin, bën që të jeni i pandalshëm përgjatë rrugës së ndërmarrë dhe nuk do të ndaloni edhe përpara të papriturave. Me ngadalë, por pashmangshmërisht, do të anashkaloni pengesën për të shkuar drejt qëllimit.

### UJORI

Po mendoni sesi ta bëni sa më të veçantë festën e ditëlindjes? Fillimisht mendoni për menynë dhe mbi të gjitha për tortën! Shpresoni të merrni një dhuratë të rëndësishme, por për të qenë të sigurt hidhuani si fjalë larg e larg të tjerëve.

### PESHQIT

Të mbështetur nga Hëna, do të jetë e lehtë të shkoni mirë me partnerin tuaj, edhe pas një zënke të vockël: të ziheni nuk do të thotë se nuk duheni! Jeni gati të hapni rrugë për personin tuaj të zemrës: për ju dashuria vjen para çdo gjëje.

Dje në 'Deutsche Welle'

# Toni i duhur në kohën e duhur

Rupert Wiederwald

(Vijon nga faqja e parë)



... parlamentare. Dhe flet atë që duhet të flasë, - mendon Rupert Wiederwald.

Është një fjalim i jashtëzakonshëm, ai që mbajti Frank-Walter Steinmeier në Mainz. Si President i Gjermanisë, detyrë e tij është që të mbetet mbipartiak dhe megjithatë, të përcjellë pozicionim. Më e mira është sikur ai të nxisë debate, pa përcaktuar rezultatin. Shpesh kjo bën që presidentët federalë të mbajnë fjalime shumë të barazpeshuara, që janë miqësore, nuk sulmojnë askënd hapur dhe prandaj shpesh janë pak të mërzitshme. Kështu që në ditën e ribashkimit gjerman do të kishte qenë normale, sikur presidenti të kishte theksuar sukseset pas 27 vjetëve bashkim të Gjermanisë Lindore dhe Perëndimore dhe të kishte skicuar problemet ekzistuese. Në Mainz, Presidenti Steinmeier nuk bëri pikërisht këtë. Në vend të kësaj, si kryetar shteti ai komentoi zgjedhjet për Bundestagun të pak ditëve më parë dhe e mori si shkas rezultatin, për të folur për mure të rinj, që nuk ndajnë vendin, por popullin. Dhe kërkoi me ngulm që dallimet të mos lejohet të kthehen në armiqësi të hapura. Këtë e kanë detyrim të gjithë, qytetarë dhe politikanë - tha Steinmeier-i. Ishte e rëndësishme që një gjë të tillë ta dëgjoje nga presidenti.

**STEINMEIERI KËRKON LIGJ EMIGRIMI**

Steinmeieri i kujtoi gjermanët që ata duhet të flasin sërish më tepër me njëri-tjetrin, në vend që të tundin kokën me mosbesim për njëri-tjetrin - në thelb një e vërtetë e thjeshtë kjo. Por, ajo për të cilën e ka fjalën Steinmeiri është: debatoni me njëri-tjetrin, i nxirrni në pah diferencat, guxoni. Kjo nuk është gjë tjetër veçse kërkesa për debate, të cilat në Gjermani shumë shpesh nuk zhvillohen dhe Steinmeieri përmend vetë temën më të rëndësishme të debatit, imigrimin. Gjermania thjesht nuk mund të shprehë dëshirën që migrimi të rrijë larg saj, tha Steinmeieri, por përkundrazi duhet të krijojë më në fund rregulla, të cilat të mundësojnë një qasje legale për emigrantët. Shkurt, Steinmeieri kërkon një ligj për emigrimin. Këtë mund ta kuptosh edhe si kritikë ndaj kancelares - partitë unioniste deri tani e kanë bllokuar me sukses një ligj të tillë emigrimi.

Dhe Steinmeieri nis në këtë kuadër një debat tjetër, të cilin shumë e kanë zhvilluar nën konceptin e përgjithshëm të "kulturës dominuese". Çfarë do të thotë të jesh gjerman, çfarë do të thotë atdhe? Në fakt ky është bazamenti më i pasigurt, mbi të cilin mund të ecë një politikan gjerman, por Steinmeieri arrin një akt balance: gjermane është pranimi i historisë gjermane dhe i vlerave demokratike - dhe kjo duhet të vlejë edhe për ata që kanë imigruar. Njëkohësisht ai e përkufizon në mënyrë individuale atdheun - secili ka një përfytyrim tjetër për atdheun, thotë Steinmeier. Shuma e këtyre atdheve individualë e bën Gjermaninë këtë vend që është.

**KUFIJ PËR AFD**

Pranimin e historisë gjermane të kohës së nacional-socializmit, kryetari i shtetit gjerman e deklaron të panegociueshëm - aq më tepër për deputetët - dhe në këtë mënyrë ai i tregon qartë kufijtë partisë së re populiste të djathtë në Bundestag. Pa e përmendur me asnjë fjalë AfD. Kaq shumë mendim ka qenë rrallë te një President i Gjermanisë. Dhe rrallë ka qenë ai kaq i nevojshëm. Në kohë të vështira nevojitet një busull, një qëndrim. Dhe kur tjetër, nëse jo tani duhet të fliste Presidenti i Gjermanisë për pasojat, që duhet të ketë rezultati i zgjedhjeve të 24 shtatorit? Ishte fjalimi i duhur në momentin e duhur. Kancelarja Angela Merkel foli në fjalën e saj për ditën e ribashkimit gjerman për shumë gjëra, që janë arritur me sukses në vitet e kaluara. Kjo mund t'i japë forcë njeriut, për të zgjidhur problemet që kanë mbetur - tha ajo.



Lojtari rrëfen bisedën me De Biazin: Na tha se nëse fitojmë, në Itali do na bëjnë heronj

# Sadiku: Dua të lë shenjë në Kombëtare

## *Spanja me lojtarë klasi, por sulmuesi beson*



Jeton Selimi

Pas dëmtimit të Sokol Cikalleshit, e vetmja pikë referimi në sulmin e Kombëtares shqiptare mbetet Armando Sadiku. 26-vjeçari nga Cërriku do të ketë barrën mbi shpatulla për të udhëhequr i vetëm repartin e avancuar, me shpresën e madhe për një mrekulli në dy sfidat spektakolare ndaj Spanjës në 6 tetor dhe ndaj Italisë në 9 tetor. Në konferencën për shtyp para gazetarëve, Sadiku nuk e ka mohuar dëshirën për të gjetur rrugën e rrjetës në të dy sfidat, si dhe tregon për mundësitë që Kombëtarja ka për të marrë një rezultat pozitiv.

**PROBLEMI TE LEGIA**

"Po, është e vërtetë që tifozët e Legias u mërzitën shumë pas ndeshjes derbi me Leç Poznan. Por është ekzagjeruar nga mediat, disa gjëra nuk janë të vërteta. Kemi pasur një takim me tifozët dhe asgjë më shumë se kaq. Ata u mërzitën, sepse, siç e thashë, është një derbi, është një ndeshje 'për jetë a vdekje', thjesht kaq."

**SPANJA E VËSHTIRË**

"Janë lojtarë të një klasi tjetër, luajnë në ekipet më të mira në botë. Ne i respektojmë. Ndeshjen e parë nuk isha, e pashë nga televizori, por besoj që do të jetë e vështirë, si të prekësh topin, si në duele. Por, nëse ne e tregojmë veten si në Europian, si me Izraelin, ne gjithmonë ndaj ekipeve të mëdha luajmë mirë. Po të luajmë si grup, mund t'ia dalim edhe këtë herë."

**BOTËRORI 2018**

**GRUPI G**

**TË PREMTEN**

| | |
|---|---|
| Itali-FYROM | 20:45 |
| Lihtenshtejn-Izrael | 20:45 |
| Shqipëri-Spanjë | 20:45 |

**RENDITJA**

| Skuadra | N | P |
|---|---|---|
| Spanja | 8 | 22 |
| Italia | 8 | 19 |
| Shqipëria | 8 | 13 |
| Izraeli | 8 | 9 |
| FYROM | 8 | 7 |
| Lihtenshtejni | 8 | 0 |

**GOL ITALISË APO SPANJËS?**

"Do të më pëlqente t'u shënoja të dyja këtyre skuadrave. Por, nëse luajmë si grup, ashtu si në ndeshje të tjera të rëndësishme si kjo, do të arrijmë t'u krijojmë vështirësi kundërshtarëve dhe të marrim rezultat. Unë shpresoj të shënoj, do të ishte mjaft bukur për mua personalisht, dhe nëse do të ndihmoja ekipin të merrte një pikë do të ishte perfekt."

**RASTI PËR TË LËNË SHENJË**

"Kur vij në ekipin kombëtar, mendoj gjithmonë se do të vij dhe të lë gjurmë në çdo ndeshje. Në ndeshjet ku kam munguar për arsye dëmtimi, qaj përbrenda meje sepse nuk jam në fushë. Në çdo ndeshje kërkoj të lë gjurmë dhe të bëj diçka që askush nuk e ka bërë. Në Kombëtare jap më të mirën time; edhe kur nuk jam në formën më të mirë, mundohem të lë zemrën në fushë."



**KONTAKTET ME DE BIAZIN**

"Nuk është se kam pasur ndonjë kontakt, thjesht i kam dërguar një mesazh, e kam uruar për detyrën e re. Nuk kam pasur ndonjë komunikim të gjatë. Para 2-3 ditësh më ka shkruar një mesazh: Në qoftë se fitoni ndaj Spanjës, do t'ju bëjnë heronj në Itali."

**PA PRESION NDAJ SPANJËS**

"Në të gjitha ndeshjet kemi dhënë me të mirën tonë. Fat i keq, që na qëlloi të kemi në grup këto dy skuadra të mëdha. Do të jenë dy ndeshje, ku më shumë do të përgatitemi për eliminatoret e Europianit. Nuk kemi presion dhe e dimë që kemi kundërshtarë shumë të fortë përballë. Thjesht duhet të shohim lojën tonë. Nuk shohim problematikën e Spanjës, që ka shumë lojtarë dhe mund të zëvendësojë këdo që mungon."

**MUNGESAT TE IBERIKËT**

"Për sa u përket lojtarëve të Spanjës, si të mungojnë si të mos mungojnë, ata janë lojtarë shumë të fortë. Luajnë në ekipet më të mira në botë. Duhet të përqendrohemi në lojën tonë."

**PËR KRISTIAN PANUÇIN**

"Trajneri ka ardhur i ri, ne ishim mësuar me De Biazin. Ai na njihte shumë mirë. Ndërsa me trajnerin e ri, edhe në stërvitje të gjithë lojtarët mundohen të japin 100 për qind. Trajneri ka futur edhe një frymë të re, na duhet pak kohë të ambientohemi, të na njohë të gjithëve mirë. E rëndësishme është të japim më të mirën, ndërsa trajneri do të provojë të eksperimentojë si për formacionin, si në grumbullime, që t'i këtë idetë më të qarta. T'i japim pak kohë dhe të shpresojmë që gjërat të shkojnë në rrugën e duhur. Jam gati të jap kontributin tim në Kombëtare. Pastaj, kur të kthehem te Legia do të jap maksimumin edhe për atje për të ndihmuar ekipin."

**"EURO 2018"**

## Ukraina thyen 19-vjeçarët e Bogdanit

Shqipëria e 19-vjeçarëve e ka nisur me humbje aven turën e saj në kualifikueset e kampionatit europian Finlandë 2018. Kuqezinjtë e drejtuar nga Erjon Bogdani janë mposhtur minimalisht nga Ukraina në 90 minutëshin e zhvilluar këtë pasdite në "Selman Stërmasi". Takimi është zhbllokuar në minutën e 30-të nga Suprihana, i cili ka shfrytëzuar më së miri gabimin e Gjurës, duke kaluar Ukrainën në avantazh. 19-vjeçarët tanë përpiqen të reagojë, por pa forcën e duhur, ndërsa në minutën e 52-të portieri Pano Qirko mban në lojë kuqezinjtë, teksa pret penalltinë e gjuajtur nga Bondar. Burba do të përpiqet të barazojë me një gjuajtje nga distanca, por gardiani finlandez është i vëmendshëm. Mbyllet 1-0 ndeshja e parë e Shqipërisë në Grupin e 12-të. Në ndeshjen tjetër të grupit të luajtur më herët në Kamëz, Norvegjia mposhti 3-0 Malin e Zi. Norvegjezët kryesojnë grupin për momentin, kurse Shqipëria ndan vendin e fundit me Malin e Zi. Të shtunën, Shqipëria do të luajë ndeshjen e dytë kundër 19-vjeçarëve të Malit të Zi.



**VEPRIMI BUJAR**




## Ronaldo dhuron trofeun e "Topit të Artë" për bamirësi

Kristiano Ronaldo nuk është nga ata që të falin në fushën e futbollit, por jashtë saj duket të jetë mjaft bujar. Ylli i Realit të Madridit ka dhuruar jo pak, por një trofe me një vlerë të lartë sentimentale dhe monetare. Kopja e trofeut të tij të Topit të Artë, e fituar në ceremoninë e Londrës në vitin 2013, është nxjerrë në ankand dhe është blerë pikërisht nga manjati izraelit Idan Ofer për shifrën e 600 mijë eurove. Fondet kanë shkuar për organizatën britanike të bamirësisë "Make A Wish", e orientuar për fëmijët që vuajnë nga sëmundje të rënda ose që janë ne stadin final të saj, dhe që ka si qëllim të bëjë reale edhe dëshirat më të çmenduara që mund të projektohen nga mendja plot fantazi e një fëmije. Pep Guardiola dhe Zhoze Murinjo, menaxherët e Sitit dhe Junajtid, gjithashtu kanë qenë kontribues të këtij eventi. Të dy teknikët mësohet të kenë paguar respektivisht nga 30 mijë euro për të parë një ndeshje boksi në Mançester, fondet e së cilës gjithashtu do të shkojnë për këtë qëllim. Trofeu i "Topit të Artë" është trofeu më prestigjioz që shkon për arritjet më të larta individuale të një futbollisti. Triumfi i Ronaldos në vitin 2013 vijoi serinë e sukseseve të tij për katër vite ndaj rivalit Lionel Mesi, me portugezin që në palmarësin tij rreshton edhe trofetë e viteve 2008, 2014 dhe 2016.

## Alarm kuqezi: Kombëtarja humb Cikalleshin

**TELASHE PËR PANUÇIN**



Një lajm i keq për trajnerin e Kombëtares, Kristian Panuçin, por edhe për të gjithë tifozët kuqezinj. Sulmuesi Sokol Cikalleshi i ka humbur dy ndeshjet e radhës me Spanjën dhe Italinë. Federata Shqiptare e Futbollit ka bërë me dije dje, se kavajasi ka pësuar një dëmtim gjatë seancës së djeshme stërvitore dhe rezonanca ka treguar se për riaftësimin e tij duhen 3 javë kohë. Cikalleshi nuk mund të luajë në dy ndeshjet e fundit eliminatore dhe do të kthehet në Turqi, pranë klubit të tij, për të nisur fazën e riaftësimit. Kështu, trajneri Panuçi ka të gatshëm vetëm sulmuesin Armando Sadiku, pasi Balaj nuk është grumbulluar për shkak se vjen nga periudhë dëmtimi. Mungon edhe Hyka.


www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
www.gsh.al
GAZETA SHQIPTARE
GSH.AL
• Na merrni!
• Na shkruani!
• Na lexoni!
GSH
www.gsh.al
Tashmë edhe lundroni!
GAZETA SHQIPTARE
KRIZA POLITIKE, SOT TAKIMI RAMA-BASHA
Agron Duka: Ju rrëfej darkën në Mullet me Fatos Nanon
BLUE TOOTH
GAZETA SHQIPTARE
500 NUMRA, NJË HISTORI SUKSESI
SUMMER
DORINA GEGIÇI
Çdo profesion ka nevojë për talent, jo sponsor
A e meriton Shën Tereza një muze në Shqipëri?!